



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

RAPORTI VJETOR

2019

Prishtinë, 2020

RAPORTI VJETOR 2019

Përmbajtja

Përmbajtja.....	5
FJALA HYRËSE E KRYETARES SË GJYKATËS KUSHTETUESE, ARTA RAMA HAJRIZI ...	7
FJALA E SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM, MILOT VOKSHI	9
RAPORT VJETOR I GJYKATËS KUSHTETUESE PËR VITIN 2019.....	10
SEKRETARIATI I GJYKATËS KUSHTETUESE	12
NJËSIA LIGJORE (NJL)	15
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS DHE BURIMEVE NJERËZORE (DABNJ)	19
DEPARTAMENTI I REGJISTRIMIT TË LËNDËVE, STATISTIKËS DHE ARKIVIT (DRLSA)	27
DEPARTAMENTI I PËRKRAHJES PROFESIONALE (DPP)	39
DEPARTAMENTI I BUXHETIT DHE FINANCAVE (DBF)	43
NJËSIA E PROKURIMIT (NJP).....	49
NJËSIA E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT, KOMUNIKIMIT DHE MULTIMEDIEVE (NJTIKM)	53
NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM (NJAB).....	57
ZYRA PER KOMUNIKIM DHE INFORMIM (ZKI)	61
AKTIVITETET E GJYKATËS KUSHTETUESE.....	65
SHTOJCA I	77
ORGANOGRAMI	81

FJALA HYRËSE E KRYETARES SË GJYKATËS KUSHTETUESE, ARTA RAMA HAJRIZI

Gjykata Kushtetuese, si autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës dhe për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Republikën e Kosovës, përmbylli vitin 2019 me aktivitete të ngjeshura dhe me numër më të madh të lëndëve të shqyrtuara se vitin paraprak.

Të gjitha aktivitetet e zhvilluara dhe vendimet e nxjerra gjatë vitit 2019, janë paraqitur në këtë raport vjetor të punës së Gjykatës, i cili, ndër të tjera, përmban edhe të dhënat statistikore përkritazi me numrin e kërkesave të parashtruara, strukturën e vendimeve, përkatësinë etnike të parashtruesve, përqindjen e lëndëve të zgjidhura dhe të bartura, si dhe natyrën e shkeljeve të pretenduara nga palët.

Shpenzimet buxhetore dhe pasqyrat financiare, vizitat studimore dhe zyrtare, struktura gjinore dhe numri i të punësuarve aktual, investimet kapitale e infrastrukture, si dhe puna e secilit departament dhe njësi organizative të Gjykatës, janë gjithashtu pjesë e këtij raporti vjetor.

Krahas prezantimit të punës njëvjeçare të secilit departament dhe njësie organizative, raporti mëton të ofrojë një pasqyrë gjithëpërfshirëse edhe mbi procedimin e lëndëve dhe të vendimmarrjes së Gjykatës.

E kur është fjala për vendimet që u morën dhe kërkesat me rëndësi që u shqyrtuan, Gjykata gjatë vitit të kaluar publikoi në ueb-faqen e saj gjithsej 184 vendime, prej të cilave 16 ishin aktgjykime.

Nga të gjitha kërkesat e parashtruara, në të cilat Gjykata gjeti shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, dëshiroj të veçoj kërkesat në vijim:

Në kërkesën KI10/18, të parashtruar nga z. Fahri Deqani, i cili kërkoi vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Pml.nr.357/2017, të 22 dhjetorit 2017, Gjykata vlerësoi se në rastin e parashtruesit të kërkesës, gjykatat e rregullta nuk kishin arsyetuar masën e vazhdimit të paraburgimit kundër parashtruesit të kërkesës dhe si rrjedhojë, Gjykata konstatoi shkelje të nenit 29, paragrafi 1, pika (2), të Kushtetutës.

Kërkesë tjetër e rëndësishme gjithashtu ishte kërkesa KI87/18, parashtruar nga “IF Skadeforsikring”, që kërkoi vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, E.Rev.nr.27/2017, të 24 janarit 2018. Në këtë rast, Gjykata konstatoi se Gjykata Supreme nuk kishte arsyetuar ndryshimin e praktikës së saj lidhur me caktimin e kamatëvonesës, çka kishte rezultuar në cenim të parimit të qëndrueshmërisë së praktikës gjyqësore dhe të sigurisë juridike, në dëm të parashtruesit të kërkesës. Gjykata konstatoi shkelje të së drejtës së parashtruesit të kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Rast tjetër me rëndësi ishte edhe kërkesa nr. KI48/18, parashtruar nga Arban Abrashi dhe Lidhja Demokratike e Kosovës, që kontestuan dy vendime të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, përkritazi me të drejtën për mbrojtje gjyqësore të të drejtave dhe të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes të garantuara me nenet 54 dhe 45 të Kushtetutës. Gjykata konstatoi se, vendimet e kontestuara të Gjykatës Supreme nuk kishin cenuar të drejtat e parashtruesve të kërkesës dhe se janë nxjerrë në pajtueshmëri me nenet 54 dhe 45 të Kushtetutës.

Përkitazi me kërkesat e parashtruara nga institucionet e autorizuar sipas nenit 113 të Kushtetutës, Gjykata gjatë vitit 2019 shqyrtoi edhe rastin KO43/19, të dorëzuar nga tridhjetë e dy (32) deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të cilët kërkuan vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit Nr.06/L-145 për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e Dialogut me Serbinë. Gjykata shpalli ligjin e kontestuar në tërësi të papajtueshëm me Kushtetutën, pasi që nenet thelbësore të ligjit në fjalë ishin në kundërshtim me nenet 4, 7, 65, 93 dhe 94 të Kushtetutës.

Vitin e kaluar, krahas vendimmarrjes dhe shqyrtimit të lëndëve, Gjykata Kushtetuese zhvilloi edhe shumë aktivitete të tjera që u realizuan në formë të vizitave zyrtare brenda dhe jashtë vendit, si dhe të pjesëmarrjes në konferenca ndërkombëtare e trajnime profesionale.

Më 23 tetor 2019, Gjykata kremtoi 10-vjetorin e themelimit të saj me një ceremoni solemne, në të cilën, së bashku me përfaqësuesit institucional e ndërkombëtar në vend, morën pjesë edhe delegacionet e nivelit më të lartë të gjykatave kushtetuese evropiane dhe të Komisionit të Venecias.


Me mbështetjen e Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë dhe të Ambasadës së Norvegjisë në Kosovë, vitin që shkoi, Gjykata Kushtetuese filloi edhe projektin që synon avancimin e kapaciteteve profesionale të Gjykatës, me qëllim të zbatimit më efektiv të standardeve evropiane në trajtimin e ankesave individuale dhe të komunikimit me publikun.

Për hollësi të mëtejshme përkitazi me aktivitetet e tjera dhe vizitat që i zhvilloi Gjykata gjatë vitit 2019, mund t'i referoheni përmbajtjes që ofron ky raport vjetor.

Në fund, dëshirojë të falënderoj përzemërsisht të gjithë gjyqtarët dhe zyrtarët e Gjykatës Kushtetuese, për angazhimin e tyre në realizimin dhe në përmbushjen me sukses të Planit vjetor të punës.

Një falënderim të veçantë dëshiroj të shpreh edhe për të gjithë partnerët dhe donatorët ndërkombëtarë të Gjykatës Kushtetuese, e në veçanti për: Zyrën e Këshillit të Evropës në Prishtinë, Agjencinë e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Agjencinë Gjermane për Zhvillim Ndërkombëtar (GIZ) dhe Fondacionin Gjerman për Bashkëpunim Ligjor Ndërkombëtar (IRZ).

Arta Rama-Hajrizi



Kryetare e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës

FJALA E SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM, MILOT VOKSHI

Kam kënaqësinë e veçantë të paraqes Raportin vjetor 2019 të punës së Sekretariatit të Gjykatës, mekanizëm ky që mbështet Gjykatën Kushtetuese dhe që siguron funksionimin efikas të administratës së Gjykatës.

Sikurse edhe raportet pararendëse vjetore, ky raport ofron një pasqyrë të aktiviteteve të Gjykatës gjatë vitit të kaluar, me fokus të veçantë në punën dhe në rezultatet e secilit departament dhe të secilës njësi të administratës së Gjykatës Kushtetuese.

Edhe gjatë vitit 2019, Sekretariati ishte i përkushtuar në arritjen e objektivave të punës dhe në përmbylljen me sukses të projekteve të parapara në Planin e punës për vitin 2019, në hartimin dhe implementimin e plotë të Planit Strategjik të Gjykatës për periudhën 2018-2020.

Në mënyrë të veçantë, Sekretariati ishte i fokusuar në plotësimin e pozitave të lira të punës, në aftësimin dhe në ngritjen e mëtejme të kapaciteteve profesionale të personelit dhe në zhvillimin, në hartimin e në zbatimin e mëtejme të rregullave dhe të procedurave të punës, për të siguruar një performancë sa më të lartë të Sekretariatit, brenda përgjegjësi që ka.

Përmbushja e objektivave të identifikuar është rezultat i punës ekipore të personelit të Sekretariatit, prandaj, sikurse viteve që shkuan, përfitoj nga rasti t'i shpreh mirënjohje të gjithë personelit të Sekretariatit për kontributin e dhënë dhe për rezultatet e arritura në zbatimin e planeve të punës, si dhe në sigurimin e funksionimit me efektivitet të lartë të Gjykatës.

Një falënderim të veçantë e meritojnë donatorët, të cilët, edhe në vitin 2019, me asistencën e tyre, ndikuan në arritjen e sukseseve të përgjithshme të Gjykatës.

Veçmas, në emrin tim dhe në emër të stafit të Sekretariatit, falënderoj gjyqtarët dhe Kryetaren e Gjykatës, mr. sc. Arta Rama-Hajrizi për inkurajimin, për përkrahjen dhe për mbështetjen profesionale që na kanë ofruar në tejkalimin e sfidave.

Sekretariati, po ashtu, edhe në vitin 2020, do të mbetet i përkushtuar në zbatimin e Planit të punës dhe të Planit Strategjik për periudhën 2018-2020.

Milot Vokshi


Sekretar i Përgjithshëm

RAPORT VJETOR I GJYKATËS KUSHTETUESE PËR VITIN 2019

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërinë e ligjeve me Kushtetutën dhe është plotësisht e pavarur në kryerjen e përgjegjësisë së saj.

Në vitin 2019, Gjykata Kushtetuese pranoi 241 kërkesa të reja.

Nga kërkesat e parashtruara në Gjykatë në vitin 2019, ajo vendosi për 133 kërkesa, ndërsa publikoi në ueb-faqen e Gjykatës dhe ua dorëzoi palëve 128 vendime.

Të gjitha vendimet e Gjykatës Kushtetuese u publikuan në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Në pajtim me nenin 115 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese aprovoi raportin e saj vjetor për vitin 2019, më 29 korrik 2020.

Në pajtim me nenin 115.2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në pajtim me rregullin 18 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës 01/2018, Sekretariati organizoi mbarrëvajtjen e 4 (katër) seancave administrative, ku u morën 23 (njëzet e tre) vendime. Ndër vendimet më të rëndësishme ishin:

- Aprovimi i Raportit vjetor të punës për vitin 2018;
- Aprovimi i ndryshimeve në Rregulloren për Njësinë Ligjore; dhe
- Aprovimi i Planit vjetor të punës së Sekretarit të Përgjithshëm për vitin 2019.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, gjatë vitit 2019, ishte e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar



**Arta Rama-Hajrizi,
kryetare**




**Bajram Ljatifi,
zëvendëskryetar**



**Bekim Sejdiu,
gjqtar**



**Selvete Gerxhaliu-
Krasniqi,
gjqtare**



**Gresa Caka Nimani,
gjqtare**



**Safet Hoxha,
gjqtar**



**Remzije Istrefi-
Peci,
gjqtare**



**Radomir Laban,
gjqtar**



**Nexhmi Rexhepi,
gjqtar**

SEKRETARIATI I GJYKATËS KUSHTETUESE

Sekretariati i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 12 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe në pajtim me rregullin 18 të Rregullores së punës 01/2018, ka kryer punët administrative dhe ka mbështetur punën e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

Sekretariati udhëhiqet nga Sekretari i Përgjithshëm, i cili sipas nenit 12.4, është përgjegjës për organizimin dhe drejtimin e Sekretariatit. Struktura organizative e Sekretariatit përbëhet nga:

- Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamenti i Administratës dhe i Burimeve Njerëzore (DABNJ);
- Departamenti për Regjistrim të Lëndëve, Statistikë dhe Arkiv (DRLSA);
- Departamenti i Përkrahjes Profesionale (DPP);
- Departamenti për Buxhet dhe Financa (DBF);
- Zyra për Komunikim dhe Informim (ZKI);
- Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB);
- Njësia e Prokurimit (NJP); dhe
- Njësia e Teknologjisë së Informacionit, e Komunikimit dhe e Multimedieve (NJTIKM).

Në realizim të objektivave të Planit Strategjik të Gjykatës Kushtetuese për periudhën 2018-2020, nga **150** aktivitetet e parapara për zhvillim gjatë vitit 2019, **131** prej tyre janë realizuar me sukses.

Funksionimi i Njesisë Ligjore (NJL), e përbërë nga këshilltarët kushtetues-juridikë dhe personeli tjetër ligjor, si dhe struktura dhe organizimi i saj, janë përcaktuar me Rregulloren nr. 03/2019 për Njësine Ligjore. Këshilltarët kushtetues-juridikë mbështesin punën profesionale të gjyqtarëve.

Gjatë vitit 2019, Sekretariati i Gjykatës Kushtetuese ka realizuar këto objektiva:

- Implementimi i Planit Strategjik 2018-2020;
- Hartimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve për vitin 2018-2020;
- Hartimi i Regjistrit të Rrezikut për vitin 2019;

Me qëllim të rritjes së nivelit të transparencës në punë, në përputhje me objektivat e Planit Strategjik të Gjykatës (2018-2020), në seancën administrative të mbajtur më 13 maj 2019, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës morën vendim që nga muaji qershor, opinioni publik dhe mediat të informohen për të gjitha rastet e shqyrtuara dhe të vendosura në seancat e rregullta shqyrtuese. Njoftimet me informata përmbledhëse përkitazi me vendimet e miratuara pas çdo seance shqyrtuese, përveç se iu dërgohen mediave, publikohen edhe në ueb-faqen e Gjykatës Kushtetuese: www.gjk-ks.org. Për aktgjykimet me rëndësi të veçantë për publikun dhe për institucionet shtetërore, njoftimet për vendimet nga seancat shqyrtuese përmbajnë informata më të detajuara përkitazi me rastin e vendosur.

Gjatë vitit të kaluar, Sekretariati i Gjykatës Kushtetuese gjithashtu publikoi:

- Raportin vjetor të punës për vitin 2018;
- Buletinin informativ nr.8 (janar-qershor 2019);
- Buletinin informativ nr.9 (korrik-dhjetor 2019);
- Buletinin e Praktikës Gjyqësore 2018, në tri gjuhë

**NJËSIA LIGJORE
(NJL)**

NJËSIA LIGJORE (NJL)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, bazuar në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregulloren e punës së Gjykatës Kushtetuese, ka themeluar Njësine Ligjore si një strukturë të veçantë organizative e cila i përgjigjet drejtpërdrejt Kryetarit dhe kryen detyrat e saj në mbështetje të punës profesionale të gjyqtarëve.

Roli parësor i Njesisë Ligjore është që të ofrojë mbështetje profesionale për gjyqtarët e Gjykatës në procesin e hartimit të raporteve paraprake; vendimeve përfundimtare të Gjykatës; si dhe, të të gjithë materialit tjetër ligjor që është i nevojshëm për punën e Gjykatës. Në këtë drejtim, Njësia Ligjore është përgjegjëse që ndihmojë Gjykatën drejt sigurimit të një kualiteti të lartë të vendimmarrjes dhe të konsistencës së praktikës gjyqësore. Për të tilla qëllime, Njësia Ligjore kryen hulumtime shtruese ligjore në nivel të së drejtës kombëtare të Republikës së Kosovës; të drejtës kushtetuese rajonale dhe ndërkombëtare; të drejtës ndërkombëtare dhe asaj krahasuese; opinioneve, rekomandimeve dhe praktikave të mira të shpallura nën ombrellën e Këshillit të Evropës dhe Komisionit të Venecias; praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë; dhe, sipas nevojës, edhe të gjykatave të tjera ndërkombëtare.

Funksionet tjera të rëndësishme të Njesisë Ligjore janë: (i) takimi me palët dhe asistimi i Sekretariatit në pranimin e kërkesave dhe dokumenteve shtesë; (ii) filtrimi i të gjitha kërkesave të reja të dorëzuara në Gjykatë dhe hartimi i një raporti fillestar filtrues në lidhje me kërkesën e dorëzuar; (iii) identifikimi i kërkesave me masë të përkohshme dhe urgjencave të tjera që një kërkesë mund të paraqet varësisht nga natyra e rastit; (iv) mbajtja dhe përditësimi i data-bazave siç janë: databaza e llojit të kërkesave dhe pretendimeve të ngritura; databaza për zbatimin e vendimeve të Gjykatës; dhe databaza për përcjelljen e gjendjes së secilit rast që nga fillimi e deri në publikimin e tij. Të gjitha vendimet e Gjykatës filtrohen nga Njësia Ligjore para publikimit në ueb-faqen e Gjykatës me qëllim të ofrimit të mundësisë për një kërkim më të lehtë shkencor, profesional dhe akademik për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës dhe komunitetin juridik.

Njësia Ligjore përbëhet nga: Këshilltari i Parë Kushtetues Juridik; Jurist-Konsulti; Zëvendës Këshilltarët e Parë Kushtetues Juridikë; Këshilltarët e Lartë Kushtetues Juridikë; Këshilltarët Kushtetues Juridikë; Këshilltari i Lartë për Administrimin e Kërkesave; dhe Sekretarët Kushtetues Juridikë. Aktualisht, Njësia Ligjore përbëhet nga 14 anëtarë dhe menaxhohet nga Këshilltari i Parë Kushtetues Juridik dhe dy zëvendësit e saj. Që të tre, përfshi Jurist-Konsultin, zgjidhen nga gjyqtarët e Gjykatës nga radha e këshilltarëve të lartë kushtetues juridikë. Këshilltari i Parë Kushtetues Juridik vepron në kapacitet ndërlidhës ndërmjet Kryetarit të Gjykatës dhe Sekretarit të Përgjithshëm dhe është përgjegjës për mbarëvajtjen e punës së Njesisë Ligjore. Ajo ndihmon dhe këshillon Gjykatën në kryerjen e funksioneve të saj si dhe mbikëqyr dhe mbështetë të gjithë anëtarët e Njesisë Ligjore në kryerjen e detyrave të tyre. Pozicioni i Jurist-Konsultit është një rol i ri në Njësine Ligjore i krijuar në vitin 2019. Roli kryesor i tij është që të këshillojë Gjykatën dhe ta njoftojë atë për çështje të ndryshme që ndërlidhen me praktikën gjyqësore të vet Gjykatës me synim të sigurimit të konsistencës së praktikës gjyqësore. Në bashkërendim me Këshilltarin e Parë Kushtetues Juridik, Jurist-Konsulti ndihmon në monitorimin e përmbajtjes së të gjitha draft-vendimeve të Gjykatës (Aktgjykimeve, Aktvendimeve dhe Vendimeve) me qëllim të sigurimit të kualitetit të lartë të vendimmarrjes dhe konsistencës së praktikës gjyqësore; dhe, në këtë aspekt, propozon rekomandime përkatëse të cilat kanë për synim konsistencën dhe kualitetin e vendimmarrjes së Gjykatës.

Anëtarët e Njesisë Ligjore kanë role specifike të krijuara për nevojat e Gjykatës. Ata kanë statusin e të punësuarit me kohë të pacaktuar dhe nuk janë shërbyes civil. Kushtet specifike të punës dhe përshkrimet e sakta të detyrave të tyre të punës janë të përcaktuara me Ligjin për Gjykatën, Rregulloren e punës dhe Rregulloren për Njësine Ligjore. Sa i përket këshillimeve që ofrojnë ata janë të pavarur dhe të lirë të shprehin mendimin e tyre profesional në lidhje me çdo kërkesë në të cilën ata punojnë.

Njësia Ligjore mban takime të rregullta për të diskutuar çështje të ndryshme juridiko-kushtetuese, për të përcjellë gjendjen e rasteve, për të rishikuar mundësitë e akteve të brendshme të Gjykatës si dhe mban konsultime rreth praktikës gjyqësore të vet Gjykatës dhe GJEDNJ-së. Po ashtu, Njësia Ligjore përgatitë materiale të ndryshme për diskutim përgjatë seancave profesionale që mbahen me gjyqtarët dhe këshilltarët e Gjykatës.

Faktor i rëndësishëm në sigurimin e vendimmarrjes efikase juridike dhe të ngritjes së hartimit të raporteve dhe të vendimeve, është trajnimi i këshilltarëve profesional të Gjykatës në fushën e së drejtës kushtetuese, ndërkombëtare dhe të të drejtave të njeriut. Në kuadër të aktiviteteve të Gjykatës, anëtarët e Njesisë Ligjore marrin pjesë në punëtori profesionale gjatë tërë vitit. Lista e plotë e aktiviteteve të këshilltarëve juridikë mund të gjendet në Pjesën IX të këtij raporti (Aktivitetet e Gjykatës).

Njësia Ligjore vazhdon të jetë e përkushtuar në ngritjen e profesionalizmit të saj, nëpërmjet realizimit të projekteve të ndryshme, që ofrohen dhe mundësohen nga partnerët strategjikë të Gjykatës Kushtetuese. Në vazhdimësi dhe përgjatë gjithë vitit, Gjykata Kushtetuese është e hapur për të ofruar takime me studentë apo nxënës të shkollave fillore dhe të mesme me qëllim të njoftimit të të gjithë të interesuarit lidhur me punën e Gjykatës Kushtetuese, rolin e saj të përcaktuar me Kushtetutë si dhe kërkesat që paraqiten pranë saj.

**DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS DHE BURIMEVE
NJERËZORE (DABNJ)**

DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS DHE BURIMEVE NJERËZORE (DABNJ)

I. Burimet njerëzore dhe ngritja e kapaciteteve

Gjatë vitit 2019, DABNJ në zbatim të vendimeve të Seancave Administrative, organizoi dhe mbështeti procedurat e rekrutimit përmes konkurseve të jashtme si dhe procedurat e avancimit përmes konkurseve të brendshme, ndërsa procedoi me përfundimin e dy konkurseve të vitit 2018 të cilat u bartën për fillim të vitit 2019.

- Përmbyllja e konkursit të vitit 2018 për plotësimin e një (1) pozite Këshilltar i lartë Kushtetues Juridik dhe dy (2) pozita Këshilltar Kushtetues Juridik (2), kandidatët e përzgjedhur u emëruan në Seancën Administrative të datës 21 janar 2019, dhe filluan punën me 1 shkurt 2019;
- Organizimi i dy (2) konkurseve të jashtme për plotësimin e dy (2) pozitave: një (1) pozitë Zyrtar për regjistrimin e lëndëve në DRLSA, kandidati i përzgjedhur filloi punën më 1 prill 2019, dhe një (1) pozitë Zyrtar për Bibliotekë, ndërsa kandidatja e përzgjedhur filloi punën me 1 qershor;
- Organizimi i pesë (5) procedurave të avancimit, përmes konkurseve të brendshme për plotësimin e pozitave: një (1) pozitë Zyrtar për regjistrimin e lëndëve në DRLSA, një (1) pozitë Drejtor i DABNJ-së, një (1) pozitë Këshilltar i Lartë Kushtetues Juridik, një (1) pozitë Këshilltar i Lartë për Administrimin dhe Filtrimin e Kërkesave, dhe një (1) Zyrtar Ligjor në Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm;
- Tre (3) pozita të reja iu shtuan Organogramit të Gjykatës, dhe atë: një (1) pozitë Menaxhere e Personelit, një (1) pozitë Këshilltare e lartë për administrimin dhe filtrimin e kërkesave dhe një (1) pozitë Juristkonsult;
- Tre (3) zyrtarë të GJKK-së përfunduan marrëdhënien e punës në GJKK, përkatësisht, një (1) vendim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës sipas dorëheqjes për pozitën Përkthyes dhe dy (2) vendime për përfundimin e marrëdhënies së punës sipas fuqisë ligjore, për pozitat Drejtor i DABNJ-së dhe Drejtor i NJP-së;
- Nëntë (9) praktikant të përzgjedhur me konkurs përfunduan punën praktike dhe të njëjtit janë pajisur me certifikata;
- Në lidhje me procedurat e rekrutimit/avancimit kemi pranuar një (1) ankesë drejtuar Komisionit të Ankesave të GJKK-së në lidhje me konkursin e brendshëm për pozitën Drejtor i Administratës dhe Burimeve Njerëzore. Pas përgjigjes së Komisionit të Ankesave, zyrtari në fjalë i është drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës;
- Në lidhje me kontestin e punës, DABNJ me ftesë të Gjykatës Themelore të Prishtinës, ka përfaqësuar (Punëmarrësin) në një (1) seancë përgatitore dhe një (1) seancë shqyrtuese në kontestin civil sipas padisë së ish zyrtarit të GJKK-së të cilit nuk iu është konfirmuar puna provuese në vitin 2016. Gjithashtu, mori pjesë edhe në një (1) seancë të shqyrtimit kryesor në Departamentin për çështje Administrative të Gjykatës Themelore, sipas padisë së Punëmarrësit kundër vendimit të TEIP për të njëjtin objekt të çështjes;

- Janë përditësuar dhe harmonizuar me listën e pagave të gjitha kontratat e punës dhe akt-emërimet e stafit të GJKK-së, si dhe janë përcjellë dhe ekzekutuar nga MAP formularët për korrigjimin dhe harmonizimin e shtesave të GJKK-së, në përputhje me kërkesat e Auditorit të Jashtëm;
- Nëntë (9) zyrtar të GJKK-së mbushën dhjetë (10) vite pune të pandërprerë në Gjykatën Kushtetuese dhe të njëjtit u shpërblyen me pagën jubilarë;
- Sa i përket zbatimit të Planit Strategjik, në çdo tre mujë është përditësuar plani i veprimit të Planit Strategjik 2018-2020 së bashku me regjistrin e rrezikut;
- Në fund të kësaj periudhe ka përfunduar procesi i vlerësimeve vjetore të performancës për të gjithë personelin kushtetues administrativ;
- Janë përgatitur dhe ofruar vërtetime të dëshmisë së punësimit sipas kërkesave të zyrtarëve. Në baza të rregullta është evidencuar vijueshmëria e stafit si dhe është bërë përditësimi i evidencës së pushimeve vjetore dhe mjekësore;
- Gjatë këtij viti, për sa i përket pushimeve të veçanta tre (3) zyrtarë të GJKK-së kanë shfrytëzuar pushimin prindëror, me 70% të pagës, dy (2) zyrtarë kanë shfrytëzuar pushim pa pagesë, një (1) zyrtar i suspenduar me pezullim të pagës 50%, si dhe një (1) zyrtarë e emëruar në funksion me pezullim të dakorduar;
- Nga numri i përgjithshëm prej 70 (shtatëdhjetë) punëtor të lejuar me buxhetin e vitit 2019, Në fund të kësaj periudhe, numri i përgjithshëm i të punësuarve në listën e pagave është 68 veta, prej të cilëve, 37 janë të gjinisë mashkullore, apo 54.4%, ndërsa 31 të gjinisë femërore, gjegjësisht 45.6%, kurse sa i përket përkatësisë nacionale 61 janë shqiptarë (89.7%), 3 serbë (4.4%), 1 turk (1.5%), 2 boshnjak (2.9%) dhe 1 malazias (1.5%). Në këtë numër janë përfshirë edhe ish kryetari i GJKK-së si dhe tre zyrtaret e emëruar nga ai sipas ligjit në fuqi.

Figura nr. 1: Numri i të punësuarve sipas përkatësisë nacionale:





Figura nr.2: Numri i të punësuarve sipas gjinisë:




II. Ngritja e kapaciteteve (trajnimet dhe zhvillimi i karrierës)

Përgjatë vitit 2019 janë realizuar gjithsej 7 vizita studimore, konferenca, takime pune, shkolla verore jashtë vendit, 4 punëtori jashtë vendit, 1 punëtori dhe 1 konference brenda vendit, 1 trajnim jashtë vendit, 22 trajnime brenda vendit, dhe 1 kurs i gjuhëve të huaja, si ndryshe vijim:

- Në Durrës janë mbajtur tre punëtori lidhur me zbatimin e Planin e Veprimit të Gjykatës Kushtetuese, dhe kanë marrë pjesë gjithsej 48 pjesëtarë nga gjykata;
- Gjykata Kushtetuese e Republikës Dominikane, në bashkëpunim me Komisionin e Venecias, ka organizuar konferencën me temën “World Conference on Constitutional Justice - 1st training on CODICES and the Venice Forum”, i cili është mbajtur në Santo Domingo, me 1 pjesëmarrës nga Gjykata;
- Vizitë pune është zhvilluar në Washington, SHBA, mbështetur nga USAID, me 12 pjesëmarrës nga Gjykata Kushtetuese;
- Në Paris, France është mbajtur trajnimi me temën “Introduction to French Judicial System”, organizuar nga Campus France, mbështetur nga Ambasada Franceze dhe Gjykata Kushtetuese, me 2 këshilltarë juridik nga Gjykata;
- Në Romë, Itali, është mbajtur takimi i 18-të i Këshillit të Përbashkët të Drejtësisë Kushtetuese të Komisionit të Venecias (JCCJ), organizuar nga Komisioni i Venecias, me 3 pjesëmarrës nga ana e Gjykatës;
- Në Podgoricë, Mal i Zi, është mbajtur Vizitë Studimore për këshilltarët juridik, e cila është organizuar nga Gjykata Kushtetuese e Malit të Zi, ku kanë marrë pjesë 7 këshilltarë juridik të Gjykatës;
- Në Tiranë, Shqipëri, është mbajtur Punëtorja për projektligjin e akteve juridike, organizuar nga OSBE, me 1 këshilltar juridik pjesëmarrës nga Gjykata;

- Shkolla e 7- të verore (7th Summer School Program), është organizuar dhe mbajtur në Ankara, Turqi me 2 këshilltarë juridik nga Gjykata;
- Në Strasburg të Francës, përkatësisht në Gjykatën Evropiane të Drejtësisë, është zhvilluar vizitë studimore, e organizuar dhe mbështetur nga Këshilli i Evropës, me 3 këshilltarë juridik nga Gjykata;
- Në Sarajevë është mbajtur Konferenca Regjionale "Shared Responsibility in Implementing the ECHR: addressing challenges with (new) judicial tools", mbështetur nga Këshilli i Evropës, me 2 këshilltarë juridik nga Gjykata;
- Në Prishtinë është mbajtur Konferenca ndërkombëtare me temën: "Freedom of Expression and Constitutional Jurisprudence in Western Balkans", organizuar nga Këshilli i Evropës me 13 pjesëmarrës nga Gjykata;
- Në kuadër të pakos së ECDL, në Prishtinë është mbajtur trajnimi nga fusha e IT-së, me temën "IT Security", organizuar nga Cacetus, me 3 pjesëmarrës nga ana e Gjykatës;
- Trajnimi për versionin e ri të sistemit të E- pasurisë për zyrtarët e IT-së, zyrtarët e logistikës, zyrtarët e depos zyrtarët e pasurisë dhe për auditor të brendshëm, është organizuar nga Agjencia e Shqipërisë së Informacionit, ndërsa është mbajtur në MAP me 6 pjesëmarrës nga Gjykata;
- Nga fusha e prokurimit janë mbajtur gjithsej 4 trajnime të organizuara nga KRPP, të mbajtura në Prishtinë ku pjesëmarrës ishin zyrtarët e Gjykatës që ndërlidhen me punën e prokurimit;
- Nga fusha e auditimit dhe financave janë mbajtur 5 trajnime, të tilla si: (i) Trajnim për ISO 9001:2015 Lead Auditor i Sistemit Menaxherial të Cilësisë, mbajtur në Prishtinë, organizuar nga Gentle Research Company" në bashkëpunim me "TRB Internationale Dokumentierung Technische Kontroll- und Überwachungswesen Industrie und Handel me 1 pjesëmarrës; (ii) trajnimi me temën "Kontrolli i Brendshëm", është mbajtur në Angli me 1 pjesëmarrës nga Gjykata; (iii) Punëtori me përfaqësuesit nga NjQH dhe NjAB-të të Nivelit Qendror, organizuar nga NJQHAB –MFE mbajtur në Prishtinë, me 1 pjesëmarrës takim informues me temën "Auditimi i pasqyrave financiare vjetore 2018, çështjet kryesore", organizuar nga zyra Kombëtare e Auditimit me 2 pjesëtarë nga Gjykata; dhe (iv) Trajnimi i organizuar nga Ministria e Financave lidhur me implementimin e tri Udhëzimeve Administrative financiare, me 2 pjesëmarrës nga ana e Gjykatës;
- Janë mbajtur 7 trajnime nga fusha e administratës dhe burimeve njerëzore të organizuara nga IKAP, me temat si në vijim: (i) "Planifikimi, menaxhimi dhe zhvillimi i Burimeve Njerëzore", me 1 pjesëmarrës; (ii) "Planifikimi strategjik, treguesit e performancës, udhëzimet administrative në fushën e planifikimit buxhetor dhe ndryshimeve buxhetore" me 2 pjesëmarrës; (iii) "Hyrje në administratën publike", me 2 pjesëmarrës; (iv) "Sistemi për mbrojtjen e të dhënave personale", me 1 pjesëmarrës; (v) "Menaxhimi i cilësisë në administratën publike", me 1 pjesëmarrës; (vi) "E drejta për informim dhe administrata publike vendore", me 2 pjesëmarrës; dhe (vii) "Qasja në dokumente publike", me 2 pjesëmarrës nga gjykata.
- Kursi i gjuhës frënge i mbështetur nga Ambasada e Zvicrës dhe organizuar nga Aleanca Franceze, është mbajtur në Gjykatë me 4 pjesëmarrës.

Figura nr. 3: Pjesëmarrja e stafit të Gjykatës Kushtetuese në vizita studimore, konferenca dhe shkolla verore jashtë vendit, konferenca/punëtori brenda dhe jashtë vendit, trajnime brenda dhe jashtë vendit, kurse të gjuhëve të huaja :



III. Mbështetja administrative dhe logjistike

- Është bërë mirëmbajtja dhe servisimi i rregullt i veturave të Gjykatës si dhe përpilimi me kohë i raporteve mujore lidhur me shpenzimin e derivateve;
- Është kryer kontrolli i hyrje-daljeve të materialit shpenzues dhe pajisjeve të IT-së, si dhe është bërë regjistrimi i tij në Sistemin e Menaxhimit të Informatave të E-pasurisë;
- Është bërë regjistrimi i 240 faturave në Sistemin Free Balance, pas furnizimit me material shpenzues dhe me pajisje të IT-së, si dhe shërbimeve për nevoja pune të Gjykatës;
- Janë përpiluar një seri shkresash drejtuar institucioneve të ndryshme lidhur me ekzekutimin e kërkesave të ndryshme administrative dhe ofrimin e shërbimeve për nevoja të Gjykatës.

IV. Biblioteka e Gjykatës (Shërbimet e bibliotekës)

Nga fusha e bibliotekës janë kryer këto aktivitete, përkatësisht është pranuar dhe regjistruar kjo literaturë:

- Dy (2) libra të fushës juridike, DE GRUYTER –Icl Journal (volume 13);
- Les cahiers Du Conseil Constitutionnel titre VII, libër i dhuruar nga Gjykata Kushtetuese e Francës;

- Gazetat Zyrtare e Republikës së Kosovës; numrat. 3, 4, 5, 6, 7, 8, 11, 15 dhe 16 të vitit 2019, me nga 3 kopje secila, botuar nga Zyra për Publikimin e Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës;
- Një (1) Revistë nga Agjencia Kadastrale e Kosovës me nr. 8 dhe 9 të vitit 2019;
- Në sistemin e integruar të bibliotekës “Koha Library” ka vazhduar migrimi i titujve të rinj, ku janë akomoduar edhe 113 tituj, të cilët janë sistemuar nëpër dollapët e tyre me kodin e fushës përkatëse, përkatësisht Kodin Decimal të Duit (DDC).

Gjykata Kushtetuese gjatë vitit 2019 është abonuar në revistat ligjore ndërkombëtare të Oxfordit, si:

- Max Planck Encyclopedia of Public International Law;
- Oxford Reports in International Law - International Human Rights Law;
- Oxford Reports in International Law - International Law in EU Courts;
- Oxford Constitutions of the World.

Biblioteka e Gjykatës Kushtetuese po ashtu përgjatë këtij viti është anëtarësuar në Asociacionin e bibliotekave Elektronike të Kosovës (ABEK), në kuadër të së cilës është mundësuar qasja në revistat elektronike ndërkombëtare si:

- Cambridge Journals Online;
- Edward Elgar Publishing;
- IMF- International Monetary Fund;
- OpenEdition Journals;
- ASTM- Compass.

**DEPARTAMENTI I REGJISTRIMIT TË LËNDËVE,
STATISTIKËS DHE ARKIVIT (DRLSA)**

DEPARTAMENTI I REGJISTRIMIT TË LËNDËVE, STATISTIKËS DHE ARKIVIT (DRLSA)

Statusi i lëndëve

Gjatë vitit 2019, Gjykata ka pasur në punë gjithsej 410 kërkesa/lëndë, nga të cilat 243 janë pranuar dhe 167 janë bartë nga vitet e kaluara :

- 11 kërkesa të bartura nga viti 2017, janë zgjidhur që të gjitha;
- 156 kërkesa të vitit 2018 janë bartur, prej të cilave 138 janë zgjidhur kurse 18 janë në proces;
- 243 kërkesa janë pranuar në vitin 2019, prej të cilave 64 janë zgjidhur dhe në proces janë 179 kërkesa.


Në total në këtë periudhë, 213 kërkesa janë zgjidhur ose 60% më shumë se në vitin e kaluar ose në numër: 80 kërkesa.

Gjatë kësaj periudhe, 183 vendime janë publikuar në ueb-faqen e Gjykatës dhe janë proceduar te palët, ndërsa 19 të tjera të zgjidhura janë në proces të përgatitjes dhe dorëzimit.

Gjatë periudhës në fjalë, mesatarisht janë pranuar 20,2 kërkesa në muaj kurse janë zgjidhur 17,7. Dinamika mujore e kërkesave të pranuar dhe të zgjidhura është si në vijim:

DINAMIKA E KËRKESAVE SIPAS MUAJVE

(I-XII 2019)



Parashtrimi i kërkesave

Juridiksioni dhe palët e autorizuar për parashtrimin e kërkesës në Gjykatën Kushtetuese është i përcaktuar me Kushtetutën dhe Ligjin për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës.

Besimi i qytetarëve në Gjykatën Kushtetuese është rritur dukshëm si rezultat i punës efikase, efektive dhe të paanshme. Departamenti për regjistrimin e lëndëve, Statistikës dhe Arkivit gjatë vitit 2019 ka pranuar 243 kërkesa të reja, nga të cilat 10 kanë qenë KO.

Struktura e kërkesave të parashtruara është si në vijim:

- 205 kërkesa kanë qenë individuale (nga personat fizikë), ose 84,4%, kurse
- 38 kërkesa nga autoritet të tjera publike (personat juridik), ose 15,6%.

Shpërndarja e kërkesave

Në përputhje me nenin 22 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, DRLSA i ka proceduar të gjitha kërkesat e parashtruara sipas nenit 113 të Kushtetutës.

Shpërndarja e kërkesave/lëndëve për Gjyqtarët raportues është bërë në përputhje me rregullin 8 dhe 34 të Rregullores së punës të Gjykatës. Përfundim nga ky rregull është shpërndarja e kërkesave për vënien e Masës së përkohshme, të cilat kërkesa procedohen sipas rregullit 55 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese, dhe rasteve *ad hoc*, të cilat paraqesin konflikt interesi, në përputhje me nenin 18 të Ligjit për Gjykatën dhe në pajtim me rregullin 7 të Rregullores së punës.

Qasja në Gjykatë dhe besimi i publikut në punën e Gjykatës


Të gjithë qytetarët e Kosovës, pavarësisht nga përkatësia etnike, fetare apo gjinore, kanë qasje të barabartë në Gjykatën Kushtetuese.

Qasja etnike e individëve tregohet me sa vijon:

- 183 kërkesa nga shqiptarët, ose 75,3 %;
- 11 kërkesa nga komuniteti serb, ose 4,5 %;
- 1 kërkesë nga komuniteti boshnjak, ose 0,4 %;
- 10 kërkesa nga nacionalitetet e tjera, ose 4,1 %; dhe
- 38 kërkesa janë parashtruar nga autoritetet të tjera publike (personat juridik), ose 15,6%.

Struktura etnike e paraqitësve të kërkesave, paraqitur në grafikun është si në vijim :


STRUKTURA E ETNIKE E PARASHTRUSËVE TË KËRKESAVE (I – XII 2019)



Qasja gjinore e parashtruesëve të kërkesave tregohet me sa vijon:

- 162 kërkesa të parashtruara nga gjinia mashkullore , ose 69,2%;
- 29 kërkesa të parashtruara nga gjinia femërore, ose 10,7%;
- 14 kërkesa të parashtruara në grup, ose 9,4%;
- 23 kërkesa të parashtruara nga organizatat punuese , ose 10,1%; dhe
- 15 kërkesa të parashtruara nga institucionet , ose 0,6% .

STRUKTURA GJINORE E PARASHTRUSËVE TË KËRKESAVE (I – XII 2019)




Llojet e shkeljeve të supozuara

Tipologjia e shkeljeve të supozuara në 243 kërkesa të pranuar në vitin 2019 është si në vijim:

- Neni 21 [Parimet e përgjithshme), 3 raste ose 1,2%;
- Neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare], 16 raste ose 6,6 %;
- Neni 23 [Dinjiteti i njeriut], 4 raste ose 1,6%
- Neni 24 [Barazia para ligjit], 59 raste ose 24,3 %;
- Neni 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm], 89 raste ose 36,6%;
- Neni 32 [E drejta për mjete juridike], 4 raste ose 1,6%
- Neni 46 [Mbrojtja e pronës], 18 raste ose 7,4%;
- Neni 49 [E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit], 8 raste ose 3,3%;
- Neni 54 [Mbrojtja gjyqësore e të drejtave], 13 raste ose 5,3%;
- Shqyrtimi kushtetues i vendimeve të autoriteteve tjera publike, 3 raste ose 1,2%; dhe
- Shkelje të tjera, 26 raste ose 10,7 %.


TIPOLOGJIA E SHKELJEVE TË SUPOZUARA (I – XII 2019)



Autorët e supozuar të shkeljes së të drejtave

- 223 kërkesa ose 91,8 % e tyre kanë të bëjnë me vendimet e gjykatave të rregullta;
20 kërkesa ose 8,2 % e tyre kanë të bëjnë me autoritetet e tjera publike.

SHKELËSIT E SUPOZUAR TË SHKELJEVE (I – XII 2019)




Afati i zgjidhjes së kërkesave

Gjatë vitit 2019, Gjykata Kushtetuese ka procesuar në tërësi, gjegjësisht i ka publikuar 183 vendime. Mesatarisht për një vendim të aprovuar dhe të publikuar u deshën 10,7 muaj ose 321 ditë.

Grafikoni në vijim pasqyron dinamikën e afatit të zgjidhjes dhe publikimit të kërkesave sipas muajve dhe ditëve i cili variron prej 8 muajve në 15,5 muaj ose shprehur në ditë nga 240 ditë në 466 ditë.

AFATI I ZGJIDHJËS SË KËRKESAVE (I – XII 2019)



Seancat dhe kolegjet shqyrtuese

Gjatë vitit 2019, Gjykata Kushtetuese ka mbajtur 39 seanca shqyrtuese me 186 kolegje shqyrtuese të cilëve iu bashkuan edhe 27 kërkesa. Gjithsej janë shqyrtuar 213 kërkesa.


Rastet e shqyrtuara u zgjidhën me aktgjykime, aktvendime, vendime për hedhje poshtë të kërkesës dhe vendime për refuzim të kërkesës me procedurë të shkurtër. Në këtë periudhë kemi edhe 1 mendim individual i cili është mendim mospajtues (në Aktgjykimin KO10/18).

Struktura e 183 vendimeve të publikuara, është si në vijim:

- 16 Aktgjykime;
- 147 Aktvendime për papranueshmëri;
- 3 Aktvendime për papranueshmëri dhe refuzim të kërkesës për masë të përkohshme;
- 8 Refuzim i kërkesës me procedurë të shkurtër;
- 1 Vendim për hedhje poshtë të kërkesës;
- 3 Vendime për tërheqjen e kërkesës nga lista dhe

- 5 Vendime për masë të përkohshme.

STRUKTURA E VENDIMEVE NË NUMËR DHE PËRQINDJE (I – XII 2019)



Në vitin 2019, Gjykata Kushtetuese i ka publikuar 16 Aktgjykime:

- Aktgjykim në rastin KI01/18, parashtrues Gani Dreshaj dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, A. A. – U. ZH. nr. 64/2017, të 26 dhjetorit 2017;
- Aktgjykim në rastin KI48/18, parashtrues Arban Abrashi dhe Lidhja Demokratike e Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit AA.nr.52/2017 të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 25 nëntorit 2017 dhe Aktgjykimit A.A. U. ZH. nr. 62/2017 të Gjykatës Supremte Republikës së Kosovës të 7 dhjetorit 2017;
- Aktgjykim në rastin KO162/18, parashtrues Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës. Konfirmimi i amandamentit të propozuar kushtetues, të paraqitur nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, më 24 tetor 2018, me shkresën nr.06/2156/DO-1156;
- Aktgjykim në rastin KO157/18, parashtrues Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së nenit 14, paragrafit 1.7 të Ligjit nr.03/L-179 për Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës;
- Aktgjykim në rastin KI87/18, parashtrues "IF Skadeforing". Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, E.Rev.nr.27/2017, të 24 janarit 2018;

- Aktgjykim në rastin KI31/18, parashtrues Komuna e Pejës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, E.Rev.nr.20/2017, të 20 nëntorit 2017;
- Aktgjykim në rastin KI171/18, parashtrues Avokati i Popullit. Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve 2, 3 (paragrafi 1, nënparagrafët 2, 3 dhe 4), 4 (paragrafi 1), 6, 7 (paragrafi 1, nënparagrafët 2, 3 dhe 4), 11 (paragrafi 3), 18, 19 (paragrafët 5, 6, 7 dhe 8), 20 (paragrafi 5), 21, 22, 23, 24 dhe 25 (paragrafët 2 dhe 3) të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;
- Aktgjykim në rastin KO43/19, parashtrues Albulena Haxhiu, Driton Selmanaj dhe tridhjetë deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 06/L-145 për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në Procesin e Dialogut me Serbinë;
- Aktgjykim në rastin KI24/17, parashtrues Bedri Salihu. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 308/2015, të 12 janarit 2017;
- Aktgjykim në rastin KI25/18, parashtrues Vasilije Antović. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 1952/2016, të 24 prillit 2017;
- Aktgjykim në rastin KI145/18, parashtrues Shehide Muhadri, Murat Muhadri dhe Sylë Ibrahim. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, AC. nr. 530/2016, të 18 qershorit 2018;
- Aktgjykim në rastin KI65/19, parashtrues Avokati i Popullit. Vlerësim i kushtetutshmërisë së nenit 32 (paragrafi 1), nenit 41 (paragrafët 1.3 dhe 1.4) dhe nenit 76 (paragrafi 2), në lidhje me nenin 2 (paragrafi 7) dhe nenin 22 (paragrafi 1.3) të Ligjit nr. 06/L-010 për Noterinë;
- Aktgjykim në rastin KI128/17, parashtrues Naser Husaj. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 170/2017, të 23 gushtit 2017;
- Aktgjykim në rastin KO58/19, parashtrues Bilall Sherifi dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimeve të Presidentit të Republikës së Kosovës, nr. 57/2019, nr. 58/2019, nr. 59/2019, nr. 60/2019, nr. 61/2019, nr. 62/2019, nr. 63/2019 dhe 65/2019, të 28 marsit 2019;
- Aktgjykim në rastin KI187/18 dhe KI11/19, parashtrues Muhamet Idrizi. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PML. nr. 226/2018, të 16 tetorit 2018 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PML. nr. 293/2018, të 3 dhjetorit 2018;
- Aktgjykim në rastin KI10/18 parashtrues Fahri Deqani. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PML. nr. 226/2018, të 16 tetorit 2018 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PML. nr. 357/2017, të 22 dhjetorit 2017.

DEPARTAMENTI I PËRKRAHJES PROFESIONALE (DPP)

DEPARTAMENTI I PËRKRAHJES PROFESIONALE (DPP)

Departamenti i Përkrahjes Profesionale (DPP) është përgjegjës për ofrimin e shërbimeve profesionale të përkthimit, të redaktimit, të lekturës dhe të harmonizimit të terminologjisë në të gjitha dokumentet e Gjykatës Kushtetuese në gjuhët në të cilat punon GJKK-ja.

DPP-ja ka organizuar, ka udhëhequr dhe ka mbikëqyrur punën e përkthimit (në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze e për ueb-faqen zyrtare të Gjykatës edhe në gjuhën turke), të redaktimit e të lekturës (në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe) dhe të përkthimit aty për aty (simultan). Kështu, nëpër DPP kanë kaluar 22.331 faqe të shkresave, të dokumenteve të ndryshme, të aktgjykimeve, të aktvendimeve, të vendimeve për heqje nga lista, të raporteve paraprake e të tjera në gjuhën shqipe, në gjuhën serbe, në gjuhën angleze dhe në gjuhën turke.

Përkthyesit kanë bërë 444 orë përkthime simultane në takime të rregullta, në seanca të Gjykatës, në seanca administrative, në intervista të kandidatëve për pozitë e shpallura nga GJKK-ja, si dhe në takime të tjera.

Në bashkërenditje me DRLSA-në, DPP-ja ka përgatitur dokumentacionin e nevojshëm për takimet e gjyqtarëve dhe për seancat shqyrtuese e administrative.

DPP-ja ka bërë procedimin e lëndëve në gjuhën shqipe, në gjuhën serbe dhe në gjuhën angleze. Njëkohësisht, ka kontribuar në publikimin e vendimeve në shqip, në serbisht, në anglisht dhe në turqisht.

Objektivat

Objektivat që ka arritur DPP-ja janë këto:

- Standardizimi i të gjitha dokumenteve zyrtare dhe i të gjitha vendimeve që mbajnë vullën e Gjykatës Kushtetuese;
- Eliminimi i mospërputhjeve në aktgjykime, në aktvendime, në raporte paraprake e në dokumente të tjera të Gjykatës;
- Nxitja në përmirësimin e kapaciteteve njerëzore dhe organizative për të vënë në praktikë menaxhimin dhe planifikimin me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë dhe për të ngritur bashkëpunimin ndërmjet departamenteve;
- Bashkëpunimi me operatorin ekonomik, sa i përket përkthimit (jashtë Gjykatës dhe në Gjykatë); dhe
- Jetësimi me sukses i të gjitha objektivave që dolën për vitin 2019 nga Plani Strategjik i GJKK-së, 2018-2020.

DEPARTAMENTI I BUXHETIT DHE FINANCIVE (DBF)

DEPARTAMENTI I BUXHETIT DHE FINANCIVE (DBF)

Mjetet e ndara nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të aprovuara për vitin 2019 janë **1,868,447.00€**.

Paga dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Investime Kapitale	Subvencione dhe transfere	Gjithsej
1,187,745.00€	491,702.00€	4,000.00€	185,000.00€	0.00 €	1,868,447.00€

Më 10 prill 2019, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës ka adresuar një kërkesë me Nr.ref. SP-672/19/mv tek Ministria e Financave për ndryshimin e buxhetit, ku nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve (13) është kërkuar të bëhet transferi në shumë prej 9,450.00€ në kategorinë e investimeve kapitale (30), në projektin me kod 11136 “Furnizim me 3(tre) vetura për Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese” dhe me këtë rast është bërë harmonizimi/ndryshimi i buxhetit fillestar.

Buxheti për gjashtëmujorin e parë të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës pas ndryshimeve i paraqitur në SIMFK, nga Buxheti i Kosovës ka qenë si në vijim:

Paga dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Investime Kapitale	Subvencione dhe transfere	Gjithsej
1,187,745.00	482,252.00	4,000.00	194,450.00	0.00	1,868,447.00

Më 23 shtator 2019, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës nëpërmjet shkresës me Nr.ref. SP-1758/19/mv ka kërkuar nga Ministria e Financave ndryshimin e buxhetit. Me këtë rast është kërkuar që nga kategoria e investimeve kapitale (30) me kod 11132 Pajisje të TI-së në shumë prej 600.00€, si dhe nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve (13) në shumë prej 51,766.00 € të rialokohen mjetet (në total 52,366.00€) në kategorinë e investimeve kapitale (30) për Projektin me kod 15556 “Mbindërtimi i Objektit Ekzistues i Gjykatës Kushtetuese” dhe me këtë rast është bërë harmonizimi/ndryshimi i buxhetit ekzistues.

Buxheti për nëntëmujorin e parë të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës pas ndryshimeve të paraqitura në SIMFK, nga Buxheti i Kosovës, është si në vijim:

Paga dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Investime Kapitale	Subvencion e dhe transfere	Gjithsej
1,187,745.00	430,486.00	4,000.00	246,216.00	0.00	1,868,447.00

Më 7 tetor 2019, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës ka pranuar nga Ministria e Financave shkresën me Nr. ref. MF-1420 e 3 tetorit 2019, “Përmbyllja e vitit fiskal 2019, dhe kursimet e mundshme nga Organizatat Buxhetore në të gjitha kategoritë e shpenzimeve”, dhe me këtë rast Gjykata Kushtetuese për vitin fiskal 2019 ka kursyer mjete nga dy kategori: Mallra dhe Shërbime si dhe në Kategorinë e Komunaleve. Që d.m.th. më 11 tetor, Gjykata Kushtetuese përmes shkresës me Nr.ref: SP-1942/19/mv tek Ministria e Financave ka kërkuar rregullimin e brendshëm të buxhetit që prej kategorisë Mallra dhe Shërbime (kodi 130) shuma prej 10,000.00€ si dhe nga kategoria e Komunaleve (kodi 132), shuma prej 1,000.00€ të transferohen në kategorinë Paga dhe Mëditje (kodi 111), me qëllim të mbulimit të pjesërishëm të pagave për muajin dhjetor 2019, kërkesë kjo që është aprovuar nga Qeveria e Kosovës përmes Vendimit nr. 02/113 i 5 nëntorit 2019. Ndërsa, nëpërmjet Vendimit, Nr. 03/115, të 17

dhjetorit 2019 të Qeverisë së Kosovës i cili aprovon kërkesën e Gjykatës Kushtetuese që Ministria e Financave të bëjë mbulimin e deficitit të pagave për muajin dhjetor 2019 në shumë prej 100,276.89€.

Buxheti përfundimtar i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës pas ndryshimeve i paraqitur në SIMFK, nga Buxheti i Kosovës si dhe bartja e donacionit nga Gjykata Kushtetuese e Turqisë nga viti 2018 në shumë prej 34.17€ paraqitet si në vijim:

Paga dhe Mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Investime Kapitale	Subvencione dhe transfere	Donacionet	Gjithsej
1,288,021.58	420,486.00	3,000.00	246,216.00	0.00	34.17	1,957,757.75

Buxheti i aprovuar 2019, alokimi dhe realizimi për periudhën Janar – Dhjetor

	Buxheti i aprovuar 2019 (A) €	Alokimet janar- dhjetor (B) €	Realizimet janar-dhjetor (C) €	% (C/A) €	% (C/B) €
Paga dhe mëditje	1,288,021.58	1,288,021.58	1,288,021.58	100	100
Mallra dhe shërbime	420,486	420,486.00	420,473.40	99.99	99.99
Shpenzime komunale	3,000.00	3,000.00	2,652.28	88.40	88.40
Subvencione dhe transfere	0,00	0.00	0.00	0.00	0.00
Investime kapitale	246,216.00	246,216.00	246,188.56	99.99	99.99
Donacionet	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Gjithsej	1,957,723.58	1,957,723.58	1,957,335.82	99.98	99.98

Alokimet e mjeteve nga buxheti i Kosovës sipas rrjedhës së parasë për periudhën Janar – Dhjetor

Në buxhetin e përgjithshëm, pjesëmarrja e alokimit në vitin fiskal 2019 ka qenë 1,957,723.58 € e shprehur në përqindje 100%.

	Janar-Shtator €	Tetor €	Nëntor €	Djetor €	Gjithsej €	%
Paga dhe mëditje	962,435.35	109,020.38	108,095.46	108,470.39	1,288,021.58	100
Mallra dhe shërbime	377,917.00	35,000.00	0.00	7,569.00	420,486.00	100
Shpenzime komunale	3,033.34	(650)	350.00	266.66	3,000.00	100
Subvencione dhe transfere	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Investime kapitale	246,216	0.00	0.00	0.00	246,216.00	100
Donacionet	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Gjithsej	1,589,601.69	143,370.38	108,445.46	116,306.06	1,957,723.58	100

Realizimi i buxhetit për periudhën Janar – Dhjetor

Realizimi i buxhetit në bazë të alokimit në vitin fiskal ka qenë **1,957,335.82 €** e shprehur në përqindje 100 %.

Realizimi i buxhetit pasqyrohet si në vijim:

	Alokimet janar – dhjetor (A) €	Realizimi janar – dhjetor (B) €	Mbetja e mjeteve (C) €	% (B/A) €
Paga dhe mëditje	1,288,021.58	1,288,021.58	0.00	100
Mallra dhe shërbime	420,486.00	420,473.40	12.60	99.99
Shpenzime komunale	3,000.00	2,652.28	347.72	88.40
Subvencione dhe transfere	0.00	0.00	0.00	0.00
Investime kapitale	246,216.00	246,188.56	27.44	99.99
Donacionet	0.00	0.00	0.00	0.00
Gjithsej	1,957,723.58	1,957,335.82	387.76	99.98

Realizimi i buxhetit për paga dhe mëditje

Realizimi i pagave dhe mëditjeve sipas muajve:

Muaji	Numri i punëtorëve	Buxheti	Realizimi	Mbetja
Janar	66	100,652.86	100,652.86	0.00
Shkurt	68	106,254.78	106,254.78	0.00
Mars	68	106,014.68	106,014.68	0.00
Prill	68	105,753.33	105,753.33	0.00
Maj	68	104,555.13	104,555.13	0.00
Qershor	69	110,997.86	110,997.86	0.00
Korrik	69	107,121.81	107,121.81	0.00
Gusht	69	112,524.52	112,524.52	0.00
Shtator	69	108,560.38	108,560.38	0.00
Tetor	69	109,020.38	109,020.38	0.00
Nëntor	69	108,095.46	108,095.46	0.00
Dhjetor	68	108,470.39	108,470.39	0.00
Gjithsej		1,288,021.58	1,288,021.58	0.00

Realizimi i buxhetit për mallra dhe shërbime

Realizimi i buxhetit në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve për vitin 2019 të ndara sipas muajve:

Muaji	Buxheti	Alokimi	Realizimi	Mbetja
Janar	42,638.50	42,638.50	35,965.03	6,718.47
Shkurt	42,638.50	42,638.50	42,789.37	(105.87)
Mars	42,000.00	42,000.00	29,833.05	12,166.95
Prill	40,000.00	40,000.00	38,999.36	1,000.64

Maj	40,000.00	40,000.00	51,557.11	(11,557.11)
Qershor	55,000.00	55,000.00	27,587.18	27,412.82
Korrik	30,000.00	30,000.00	52,314.06	(22,314.06)
Gusht	30,000.00	30,000.00	29,369.19	630.81
Shtator	55,550.00	55,550.00	31,144.03	24,405.97
Tetor	35,000.00	35,000.00	19,808.97	15,191.03
Nëntor	0.00	0.00	50,982.50	(50,982.50)
Dhjetor	7,569.00	7,569.00	10,123.55	(2554.55)
Gjithsej	420,486.00	420,486.00	420,473.40	12.60

Buxheti i ndarë për investime kapitale sipas kodeve të projekteve

Projektet	Kodet e projekteve	Buxheti i aprovuar €	Realizimi €	Mbetja €
Pajisje të TI –së	11132	29,400.00	29,379.26	20.74
Automjetet	11136	59,450.00	59,450.00	0.00
Renovimi i objektit të GJKK-së	15556	157,365.99	157,359.30	6.69
Gjithsej:		246,216.00	246,188.56	27.44

Realizimi i buxhetit për shpenzime komunale

Realizimi i buxhetit në kategorinë e shpenzimeve komunaleve për vitin 2019 të ndara sipas muajve:¹

Muaji	Buxheti	Alokimi	Realizimi	Mbetja
Janar	291.67	291.67	253.07	38.60
Shkurt	291.67	291.67	255.15	36.52
Mars	350.00	350.00	0.00	350.00
Prill	350.00	350.00	484.39	(134.39)
Maj	350.00	350.00	205.08	144.92
Qershor	350.00	350.00	213.50	136.50
Korrik	350.00	350.00	206.01	143.99
Gusht	350.00	350.00	207.30	142.70
Shtator	350.00	350.00	199.76	150.24
Tetor	(650)	(650)	216.00	(433.98)
Nëntor	350.00	350.00	201.45	148.55
Dhjetor	266.66	266.66	210.55	56.11
Gjithsej	3,000.00	3,000.00	2,652.28	347.72

¹ Shpenzimet e komunaleve nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës janë bërë vetëm në kodin e telefonisë fikse, ndërsa shpenzimet e rrymës dhe mbeturinave mbulohen nga Ministria e Administratës Publike.

NJËSIA E PROKURIMIT (NJP)

NJËSIA E PROKURIMIT (NJP)

Në mbështetje të planit të prokurimit për vitin 2019, Njësia e Prokurimit ka iniciuar dhe zhvilluar gjithsej 31 aktivitete të prokurimit dhe janë nënshkruar 35 kontrata.

Bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik, aktivitetet e prokurimit i kemi klasifikuar sipas tipit, vlerës dhe procedurës dhe në vijim i paraqesim në detaje:

- a. Procedurë me vlerë minimale (deri 1000 euro);
- b. Procedurë e kuotimit të çmimeve (vlerë e vogël);
- c. Procedurë e hapur (vlerë e mesme).

a) Procedurë me vlerë minimale

Gjatë vitit 2019 janë iniciuar dhe zhvilluar gjithsejtë 12 (dymbëdhjetë) aktivitete dhe janë nënshkruar 12 (dymbëdhjetë) kontrata.

1. Riparimi dhe funksionalizimi i sistemit elektrik në kontejner;
2. Projekti ideor për mbindërtim në objektin ekzistues të GJKK-së;
3. Vendosja e perdeve në zyrat e objektit të GJKK-së;
4. Riparimi i pelerinave (manteleve) të gjyqtarëve të GJKK-së ;
5. Servisimi dhe mirëmbajtja i rregullt mujor të ashensorit në objektin e GJKK-së;
6. Furnizimi dhe instalimi i AC-ve (air conditioner) dhe mbushja me gaz e AC-ve ekzistuese sipas nevojave në objektin e GJKK-së;
7. Furnizimi dhe montimi me drita emergjente;
8. Shërbime të sigurimit kasko në EU, TPL dhe TPL+ për tri vetura zyrtare;
9. Furnizimi dhe instalimi i AC-ve (air conditioner) dhe mbushja me gaz e AC-ve ekzistuese sipas nevojave në objektin e GJKK-së;
10. Furnizim me veshmbathje për vozitës të GJKK-së;
11. Servisimi dhe mirëmbajtja e gjeneratorit; dhe
12. Ndërrimi dhe montimi i gomave, balancimi dhe hotelimi (ruajtja) e gomave.

b) Procedurë e kuotimit të çmimeve (vlerë e vogël)

Gjatë vitit 2019 janë iniciuar dhe zhvilluar gjithsejtë 6 (gjashtë) aktivitete dhe janë nënshkruar 7 (shtatë) kontrata.

1. Blerja e telefonave (Smartphone);
2. Hartimi i projektit kryesor për mbindërtim në objektin ekzistues të GJKK-së;
3. Furnizim me softuer dhe pajisje për regjistrim audio dhe video;
4. Servisimi dhe mirëmbajtja e sistemit të serverëve -Lot 1 dhe Lot 2- Servisimi dhe mirëmbajtja e Pajisjeve të IT-së;
5. Mbikëqyrja e projektit për mbindërtim në objektin e GJKK-së; dhe
6. Furnizimi me gazeta ditore dhe javore.

c) Procedurë e hapur (vlerë e mesme)

Gjatë vitit 2019 janë iniciuar dhe zhvilluar gjithsejtë 14 (katërmëdhjetë) aktivitete dhe janë nënshkruar 16 (gjashtëmbëdhjetë) kontrata, në vijim paraqesim:

1. Shërbime me pije joalkoolike dhe pije të nxehta për nevoja të stafit të GJKK-së;

2. Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të GJKK-së – tri Lote: Lot 1 - Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve VW, Audi dhe Shkoda; Lot 2 - Servisimi dhe mirëmbajtja e automjetit Toyota RAV4; dhe Lot 3 - Servisimi dhe mirëmbajtja e automjetit Mitsubishi Lancer 1.5 benzinë;
3. Blerja e automjeteve për nevoja të GJKK-së;
4. Blerja e serverit (back-up);
5. Blerja e desktop all in one PS, lap top, ups;
6. Shërbime të mbjelljes dhe furnizimit me lule të gjalla;
7. Shërbime të ofrimit të furnizimeve punim dore nga argjendi;
8. Furnizim me material sanitar dhe elektrik;
9. Mbindërtimi në objektin ekzistues të GJKK-së;
10. Shërbime për shpalljen e konkurseve, reklamave, njoftimeve në gazeta ditore;
11. Shërbime të larjes së veturave të GJKK-së;
12. Organizimi i ceremonisë solemne dhe i konferencës ndërkombëtare për 10 vjetorin e GJKK-së - Lot 1 dhe Furnizimi me artikuj ceremonial me rastin e konferencës ndërkombëtare - Lot 2; dhe
13. Furnizimi me material shpenzues zyrtar.

Gjatë vitit 2019, nuk është iniciuar dhe zhvilluar asnjë aktivitet me vlerë të madhe.

Pasqyrimi në tabelë i të gjitha pagesave të realizuara gjatë vitit 2019 si dhe furnizimeve, shërbimeve dhe punëve për kontratat e nënshkruara.

Pagesat e furnizimeve, shërbimeve dhe punëve për kontratat e nënshkruara në vitin 2019	Shuma e përgjithshme e pagesave gjatë vitit 2019
Shuma e kontratave, duke përfshirë të gjitha taksat etj.	142,877.34€
Shuma e paguar për kontrata	299,399.09€
Shuma e përgjithshme	442,276.43€

**NJËSIA E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT,
KOMUNIKIMIT DHE MULTIMEDIEVE (NJTİKM)**

NJËSIA E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT, KOMUNIKIMIT DHE MULTIMEDIEVE (NJTIKM)

Njësia e Teknologjisë së Informacionit, Komunikimit dhe Multimedieve është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve dhe përkujdesjen profesionale në infrastrukturën e përgjithshme të teknologjisë informative në Gjykatë Kushtetuese.

Gjatë viti 2019, Njësia TIK dhe Multimedia ka realizuar projektet dhe detyrat sipas planit dhe përgjegjësi të saj, duke krijuar një sistemi të qëndrueshëm dhe profesional me pajisje të avancuara teknologjike, në përputhje me planin e punës dhe Planit strategjik të Gjykatës Kushtetuese.

Projektet e realizuara

- Instalimi i serverit back-up dhe fillimi i migrimit të domain controllerave në serverin e ri në Microsoft Windows Server 2016, sipas planit të paraparë, migrimin e të dhënave dhe ngritjen e sistemeve operative të serverëve nga Windows 2008 në Windows 2016;
- Intervenimi dhe konfigurimi i politikave të reja të sigurisë në Domain Admin Group DC/GJJK për regjistrimin e shfrytëzuesve në Firewallle (murin mbrojtës) kryesor të sigurisë;
- Është përfunduar montimi, instalimi dhe konfigurimi i pajisjes dhe softuerit për regjistrimin e audio dhe video të seancave në gjykatore;
- Përfundimi dhe instalimi i versionit të fundit CDMS me ndryshimet e fundit sipas kërkesave që janë paraqitur dhe është mbajtur trajnimi për te gjithë gjyqtarët për përdorimin e ndryshimeve të fundit;
- Përfundimi dhe dorëzimi i pyetësorëve të raportit të Auditimit të Brendshëm sipas planit të paraparë për Auditimin e Njesisë së TIK-ut;
- Gjatë vitit 2019 janë iniciuar gjithsej 7 procese të prokurimit për blerjen e pajisjeve të ndryshme të IT-së, softuer dhe pjesë përcjellëse sipas planit të paraparë për këtë vit;
- Formatimin dhe përgatitjen për shtyp të dokumenteve të ndryshme sipas kërkesave, siç janë: formatimi i Planit Strategjik 2017-2020, buletinit të praktikës Gjyqësorë 2017, pjesa e parë dhe pjesa e dytë dhe dorëzimi i tij te grupi punues për publikim, formatimi i Kushtetutës në gjuhen serbe në formatin A6 dhe dorëzimi në Sekretariat për printim, dizajnimi dhe përgatitja e librit të Gjykatës për vitin 2018.

Aktivitetet e ndërmarra

- Menaxhimi dhe organizimi i detyrave teknike dhe operative brenda Njesisë duke ofruar përkrahjen e nevojshme për funksionalizimin sa më të mirë të pajisjeve të Teknologjisë Informative dhe sistemeve brenda Gjykatës;
- Intervenimet teknike në pajisje të IT-së, në bazë të kërkesave nga stafi;
- Kontrollimi dhe mirëmbajtja e sistemit të domenit të Gjykatës dhe krijimi i politikave të sigurisë në serverët e Gjykatës;

- Monitorimi dhe kontrollimi i sigurisë së rrjetës brenda Gjykatës dhe përditësimi i versioneve të reja (update) për të gjitha pajisjet duke i aprovuar dhe instaluar nga Administratori i Sistemit;
- Avancimi në ngritjen e sistemeve operative në Windows 10 dhe softuerët e tjerë aplikativ;
- Montimi, instalimi dhe konfigurimi i kompjuterëve të ri (HP all-in-one) dhe regjistrimi në domenin e GJKK-së, transferimi i të dhënave;
- Pjesëmarrja në tri punëtori të organizuar nga Gjykata për Planin e Veprimit të Planit Strategjik 2017-2019;
- Përditësimi i versioneve të reja për sistemin e telefonisë fikse VOIP-tel, nxjerrja dhe analizimi i shpenzimeve nga sistemi i telefonisë VOIP;
- Përkujdesje dhe mbarëvajtje e pajisjeve të zërimit dhe sistemit të përkthimit në gjykatore gjatë mbajtjes së seancave;
- Publikimi i 168 vendimeve në Ueb Faqe në tri gjuhët zyrtare dhe kategorizimi i tyre bazë i listës së filtrimit;
- Përkujdesje dhe ofrim i shërbimeve për mbarëvajtjen e sistemeve dhe pajisjeve të teknologjisë Informative dhe komunikimit; dhe
- Përkujdesje në krijimin i kopjeve (back-up) të domenit të Gjykatës dhe sistemit të CDMS-it.

NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM (NJAB)

NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM (NJAB)

1. Njësia e Auditimit të Brendshëm

Bazuar në planin vjetor për vitin 2019, NJAB ka përfunduar me kohë të gjitha auditimet e planifikuara, si:

- Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve gjatë vitit 2018;
- Menaxhimi i pasurisë (auditim me kërkesë nga menaxhmenti);
- Funksionimi i Teknologjisë Informative në GJKK;
- Menaxhimi i prokurimit;
- Menaxhimi i shpenzimeve; dhe
- Menaxhimi i logjistikës.

Si dhe ka hartuar dhe ka dorëzuar brenda afatit të caktuar:

- Planin strategjik të auditimit të brendshëm për periudhën 2020-2022; dhe
- Planin vjetor të auditimit të brendshëm për vitin 2020.

Të gjitha auditimet e brendshme janë zhvilluar në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe me qëllim të realizimit të objektivave të institucionit dhe të NJAB që kanë të bëjnë me kontrollin e brendshëm dhe me përmirësimin e efikasitetit në punë, me shmangien e gabimeve të mundshme, me rritjen e vlerës dhe me raportimin e parregullsive dhe gabimeve me qëllim të shtimit të kontrollit që të ofrojë siguri tek menaxhmenti për funksionim efikas në departamentet përkatëse.

Në vazhdimësi janë bërë vizita përcjellëse për efikasitetin e sistemeve të menaxhimit dhe të funksionimit të kontrollit të brendshëm, si dhe të zbatimit të rekomandimeve nga Auditori i Brendshëm dhe nga Auditori i Përgjithshëm.

Menaxhmenti ka vlerësuar punën e auditorëve dhe në rastin e parë të mundshëm është kujdesur për implementimin e rekomandimeve të dhëna si nga auditori i brendshëm, gjithashtu edhe nga auditorët e përgjithshëm, e kjo ka ndikuar në ngritjen e cilësisë së aktiviteteve dhe performancës së institucionit.

Njësia e Auditimit të Brendshëm ka realizuar planin për vitin 2019 dhe ka bërë përcjelljen për zbatimin e rekomandimeve. Punë shtesë me kërkesë nga menaxhmenti kemi pasur një auditim në sistemin qeveritar të E-pasurisë, me të cilin kemi vazhduar në tremujorin e parë.

2. Komiteti i Auditimit të Brendshëm

Komiteti i Auditimit të Brendshëm është organ i pavarur këshillëdhënës në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, dhe funksionon bazuar në:

- Udhëzimit Administrativ për Themelimin dhe Funksionimin e Komitetit të Auditimit në subjektet e Sektorit Publik;
- Statutin e KAB;
- Praktikën e mira të Komitetit të Auditimit të Brendshëm; dhe
- Standardet ndërkombëtare të auditimit.

Komiteti i Auditimit të Brendshëm, gjatë vitit 2019 ka mbajtur 4 takime dhe ka siguruar mbikëqyrje të planeve, raporteve dhe të implementimit të rekomandimeve të dhëna nga auditorët.

ZYRA PER KOMUNIKIM DHE INFORMIM (ZKI)

ZYRA PËR KOMUNIKIM DHE INFORMIM (ZKI)

Zyra për Komunikim dhe Informim (ZKI) në fushën e përgjegjësi të saj përfshinë: informimin dhe komunikimin me mediat/publikun, monitorimin e mediave, publikimin e njoftimeve në ueb-faqen e Gjykatës përkitazi me vizitat/aktivitetet dhe seancat/vendimet, publikimin e Buletinit Informativ të Gjykatës, publikimin e Librit të Gjykatës dhe të fletushkave/broshurave të tjera informative, komunikimin me palët/qytetarët, protokollin, kërkesat për qasje në dokumentet zyrtare të Gjykatës dhe mbrojtjen e të dhënave personale si dhe bashkëpunimin me Komisionin e Venecias.

Gjatë vitit 2019, në Zyrën për Komunikim dhe Informim janë kryer këto aktivitete:

I. Monitorimi i mediave:

- Janë përpiluar 150 raporte ditore të mediave;
- Janë përpiluar 51 raporte javore të mediave;
- Është botuar Raporti vjetor i mediave për vitin 2018; dhe
- Është bërë arkivimi fizik dhe elektronik i raporteve të mediave të shtypura (262 artikuj) dhe të mediave elektronike (720 artikuj) përkitazi me punën e Gjykatës.

II. Komunikimi me mediat/publikun:

- Janë dërguar përgjigjet në 181 pyetje të parashtruara nga mediat e shkruara dhe ato elektronike si dhe në 263 pyetje/kërkesa të parashtruara nga qytetarët dhe institucionet;
- Janë publikuar 30 njoftime përkitazi me vizitat dhe aktivitetet e Gjykatës;
- Janë publikuar 12 njoftime me informata statistikore përkitazi me seancat dhe vendimet e Gjykatës; dhe
- Janë publikuar 20 njoftime me informata përmbledhëse përkitazi me vendimet e Gjykatës pas seancave shqyrtuese.

III. Publikimi i fletushkave/broshurave dhe i materialeve të tjera informative:

- Është publikuar numri i 7-të dhe i 8-të i Buletinit Informativ të Gjykatës;
- Janë përgatitur dhe publikuar në ueb-faqen e Gjykatës dy video-animacione përkitazi me punën e Gjykatës Kushtetuese dhe me parashtrimin e kërkesave në Gjykatë;
- Është përgatitur dhe publikuar video promovuese për 10-vjetorin e themelimit të Gjykatës; dhe

- Janë publikuar fletushkat/broshurat informative: 1. “Gjykata Kushtetuese në 40 pyetje”, 2. “Gjykata Kushtetuese (shkurt)” dhe 3. “Parashtrimi i kërkesës në Gjykatën Kushtetuese”.

IV. Aktivitetet protokollare:

- Janë kryer detyrat protokollare përkitazi me 28 vizita zyrtare në Gjykatë, 19 vizita zyrtare jashtë vendit, 10 punëtori/konferenca të organizuara në vend dhe 6 punëtori/konferenca të organizuara jashtë vendit.

V. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare:

- Gjatë vitit 2019 janë pranuar gjithsej 23 kërkesa për qasje në dokumentet zyrtare të Gjykatës. Të gjitha kërkesat janë aprovuar nga Gjykata;
- Janë dorëzuar 4 raport tremujore përkitazi me kërkesat për qasje në dokumentet zyrtare të Gjykatës; dhe
- Është përgatitur Raporti vjetor për kërkesat për qasje në dokumentet zyrtare të Gjykatës për vitin 2019.

VI. Komunikimi me palët/qytetarët:

Gjatë vitit 2019, në recepsionin e Gjykatës janë regjistruar dhe proceduar:

- 339 qytetarë;
- 244 përfaqësues institucionesh.

VII. Bashkëpunimi me Komisionin e Venecias:

- Janë dërguar përgjigjet e Gjykatës në 90 pyetje të parashtruara nëpërmjet Forumit të Komisionit të Venecias nga 15 gjykata kushtetuese dhe gjykata supreme të shteteve anëtare (*nëpërmjet 26 kërkesave*);
- Janë dorëzuar 3 raporte katër-mujore, së bashku me vendimet më të rëndësishme të Gjykatës gjatë kësaj periudhe, për publikim në Buletinet e Komisionit të Venecias; dhe
- Nga Gjykata është parashtruar 1 kërkesë (*me 6 pyetje*) në Forumin e gjykatave kushtetuese dhe supreme të shteteve anëtare të Komisionit të Venecias.

AKTIVITETET E GJYKATËS KUSHTETUESE

AKTIVITETET E GJYKATËS KUSHTETUESE

I. Udhëtimet zyrtare

22 - 23 mars 2019

Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese, z. Bekim Sejdiu mori pjesë në Forumin e Gjashtë Rajonal mbi Shtetin e së Drejtës në Evropën Juglindore, me ftesë të AIRE Centre dhe Civil Rights Defenders, më 22 dhe 23 mars 2019, në Dubrovnik, Kroaci.

Qëllimi i këtij Forumi ishte të promovojë zbatimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në nivel vendi, të nxisë bashkëpunimin rajonal për avancim të vazhdueshëm të sundimit të ligjit dhe të të drejtave të njeriut, dhe të ndihmojë në proceset e integritetit evropiane në rajon.

Temë e Forumit 2019 ishte të Drejtat e Fëmijëve dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

14 - 20 prill 2019

Një delegacion i gjyqtarëve dhe këshilltarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i udhëhequr nga Kryetarja e Gjykatës, znj. Arta Rama-Hajrizi, ka udhëtuar për një vizitë pune disaditëshe në Uashington, më 14 - 20 prill 2019.

Gjatë qëndrimit në kryeqytetin amerikan, delegacioni i Gjykatës Kushtetuese vizitoi Gjykatën e Qarkut të SHBA-ve për Qarkun e Kolumbisë (DC), Gjykatën e Apelit të Qarkut të DC, si dhe Gjykatën Supreme të Shteteve të Bashkuara, ku kishin mundësinë edhe të marrin pjesë në prezantimin dhe në argumentimin oral të rastit, “*Shtetet e Bashkuara kundër Davis*”.

Në vazhdim të qëndrimit në Uashington, gjyqtarët dhe këshilltarët e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës vizituan edhe Qendrën Federale Gjyqësore, si dhe Zyrën Administrative të Gjykatave të Shteteve të Bashkuara, për të mësuar më shumë rreth rolit të Zyrës Administrative, etikës gjyqësore në Shtetet e Bashkuara, si dhe raportin e gjyqësorit federal me mediat dhe me publikun.

Pas vizitës në Byronë e Agjencisë USAID për Evropë dhe Euroazi, qëndrimi i delegacionit të Gjykatës Kushtetuese në Uashington u përmbyll me vizitën në Fakultetin Juridik të Universitetit Amerikan, ku ndër të tjera, u diskutua mbi të drejtën kushtetuese dhe teoritë e interpretimit kushtetues, si dhe interpretimin e kriterëve të pranueshmërisë në përzgjedhjen e lëndëve për shqyrtim.

Vizita e delegacionit të Gjykatës Kushtetuese në SHBA është mundësuar me mbështetjen e Programit të USAID-it për Fuqizimin e Sistemit të Drejtësisë në Kosovë (JSSP).

19 - 25 maj 2019

Me mbështetje nga Ambasada e Francës, dy këshilltarë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Arbana Beqiri dhe z. Srđan Staletovic, morrën pjesë në programin e “*Introduction to the French Justice System*”, nga data 19 - 25 maj 2019, në Paris, Francë.

23 - 25 maj 2019

Një delegacion i Gjykatës i përbërë nga z. Milot Vokshi - Sekretar i Përgjithshëm, z. Veton Dula - Drejtor i Departamentit për Komunikim dhe znj. Vesa Zekaj - Këshilltare për Marrëdhënie Ndërkombëtare; marrin pjesë në takimin “*18th Meeting of the Joint Council on Constitutional Justice*”, të organizuar nga Komisioni i Venecias (Venice Commission) më 23 - 25 maj 2019, në Romë të Italisë.

Qëllimi i pjesëmarrjes dhe takimeve me përfaqësuesit e shteteve anëtare të Komisionit të Venecias (Venice Commission) kishte për qëllim bashkëpunim e mëtejshëm mbi iniciimin dhe realizimin e organizmit të Konferencës së 20-të që do të mbahet në Kosovë në vitin 2021.

10 - 12 qershor 2019

Një delegacion i Gjykatës i përbërë nga Këshilltari i Parë Juridik z. Sevdail Kastrati dhe të gjithë këshilltarët juridikë të Gjykatës morën pjesë në një punëtori të përbashkët me Gjykatën Kushtetuese të Malit të Zi, të organizuar në Podgorica, më 10 - 12 qershor 2019.

Në punëtorinë e përbashkët, dy palët diskutuan çështje me rëndësi përkitazi me veçoritë dhe dallimet në organizimin e punëve të departamenteve ligjore dhe llojet e bashkëpunimit në mes të këshilltarëve dhe gjyqtarëve të të dy Gjykatave Kushtetuese.

27 - 29 shtator 2019

Një delegacion i gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, në krye me Kryetaren e Gjykatës, znj. Arta Rama-Hajrizi, qëndroi për vizitë pune në Gjykatën Kushtetuese të Italisë, me seli në Romë, më 27 shtator 2019.

Delegacioni i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës u prit në takim nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Italisë, z. Giorgio Lattanzi, dhe dy zëvendëskryetarët e kësaj Gjykate, znj. Marta Cartabia dhe z. Mario R. Morelli.

Gjatë bashkëbisedimit, të dyja palët shkëmbyen përvojat dhe pikëpamjet e tyre përkitazi me sistemet respektive gjyqësore të të dyja vendeve, duke pasur në fokus veçanërisht pavarësinë funksionale të gjykatave kushtetuese, procesin e emërimit të gjyqtarëve kushtetues si dhe reformat ligjore në sistemin e drejtësisë. Kontrolli kushtetues i akteve të autoriteteve qendrore, shqyrtimi i vendimeve të gjyqësorit të rregullt dhe thellimi i bashkëpunimit në fushat me interes reciprok, ishin gjithashtu temë e diskutimit në takim. Gjyqtarët e të dy gjykatave në vazhdim morën pjesë në një punëtori të përbashkët, ku ndër temat e trajtuara ishte edhe roli i gjykatave kushtetuese në zbatimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

18 - 24 shtator 2019

Me ftesë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Turqisë, një delegacion i këshilltareve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, z. Bardh Bokshi dhe z. Dukagjin Abdyli morën pjesë në programin e “7th Summer School of the AACC”, nga data 18 - 24 shtator 2019, në Ankara të Turqisë.

4 - 5 tetor 2019

Me ftesë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Lituanisë dhe Profesorit Rainer Arnold, nga Universiteti i Regensburgut, Gjyqtarja Selvet Gerxhaliu Krasniqi mori pjesë në Kongresin e XII Ndërkombëtar për të Drejtën Evropiane dhe të Drejtën Kushtetuese Krahasihtarë, që u mbajt në Vilnius të Lituanisë nga 4 deri më 5 tetor 2019.

Tema e Kongresit të XII ishte “Koncepti i Demokracisë i zhvilluar nga Drejtësia Kushtetuese”.

8 - 9 tetor 2019

Në kuadër të një Projekti të Ministrisë së Integrimit Evropian, Këshilltari i parë Ligjor z. Seveda Kastrati, mori pjesë në një vizitë të përbashkët studimore me zyrtarë të tjerë të sistemit të drejtësisë në Kosovë, në një vizitë studimore në Strasburg, më 8 - 9 tetor 2019.

18 - 24 tetor 2019

Në kuadër të projektit të Këshillit të Evropës në Prishtinë, një delegacion i këshilltareve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, z. Srđan Staletović dhe z. Boban Petković morë pjesë në një Konferencë Rajonale “Përgjegjësia e ndarë në implementimin e KEDNJ-së adresimi i sfidave me mjete gjyqësore (të reja)”, më 24 - 25 tetor 2019, në Sarajevë.

II. Vizita zyrtare në Gjykatën Kushtetuese/Aktivitete të tjera

19 - 22 shkurt 2019

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës mbajti punëtorinë e Planit të Veprimit të Planit Strategjik të Gjykatës Kushtetuese 2018 - 2020, më 19 - 22 shkurt 2019, në Durrës, Shqipëri.

21 mars 2019

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës në bashkëpunim me Zyrën e Këshillit të Evropës në Prishtinë dhe me përkrahjen e ambasadës së Norvegjisë në Kosovë, organizuan punëtorinë e përbashkët me temë: “*Përmirësimi i mbrojtjes së standardeve evropiane të të drejtave të njeriut nga Gjykata Kushtetuese*”, më 21 mars 2019, në Prishtinë.

Punëtorja e mbajtur shënoi edhe fillimin e projektit të mbështetur nga Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë dhe nga Ambasada e Norvegjisë në Kosovë, që synon avancimin e kapaciteteve profesionale të Gjykatës Kushtetuese, me qëllim të zbatimit më efektiv të standardeve evropiane në trajtimin e ankesave individuale dhe komunikimin me publikun.

8 prill 2019

Nxënës të shkollave fillore nga qytete të ndryshme të Republikës së Kosovës vizituan Gjykatën Kushtetuese më 8 prill 2019, me rastin e shënimit të 11-vjetorit të Kushtetutës së Kosovës.

Ata u pritën në takim nga Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese, znj. Arta Rama-Hajrizi, e cila pasi që u shprehi mirëseardhjen, i njoftoi në pika të shkurtra me funksionin dhe rolin me rëndësi që ka Gjykata Kushtetuese për sundimin e ligjit në vend si dhe për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të njeriut sipas standardeve evropiane.

Kryetarja Rama-Hajrizi në vazhdim i njoftoi filloristët edhe me strukturën organizative të Gjykatës dhe përbërjen e saj, me procesin e zgjedhjes dhe mandatin e gjyqtarëve kushtetues si dhe me procedurat e shqyrtimit të kërkesave të parashtruara.

Ajo foli edhe për procesin e hartimit të Kushtetutës së re të Republikës së Kosovës si dhe për rëndësinë që ka ky dokument jo vetëm për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në vend, por edhe për të gjitha proceset e zhvillimit demokratik të shoqërisë tonë.

Vizita e nxënësve u realizua nën organizimin e përbashkët të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe të Programit për Transformim të Liderimit (TLP) të Agjencisë së SHBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID).

17 prill 2019

Gjykatën Kushtetuese e vizituan studentët e vitit të katërt të Fakultetit Juridik të Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren, të shoqëruar nga profesori universitar dhe ish-nënkryetari i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, Prof. dr. Kadri Kryeziu.

Studentët u pritën në takim nga zëvendës-këshilltari i parë juridik i Gjykatës Kushtetuese, z. Nexhat Kelmendi, dhe nga drejtori i Zyrës për Komunikim dhe Informim (ZKI), z. Veton Dula.

Këshilltari Kelmendi fillimisht i njohu studentët me funksionin, me përgjegjësitë dhe me rolin që ka Gjykata Kushtetuese e Kosovës në raport me organet e tjera të pushtetit shtetëror dhe me gjykatat e rregullta në vend. Këshilltari Kelmendi në vazhdim bëri një prezantim të shkurtër përkitazi me palët e autorizuar sipas Kushtetutës për të parashtruar kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, me ç’rast për secilën palë parashtruese ai bëri një elaborim krahasues me vendimet e nxjerra deri më tani nga gjykata.

Ai diskutoi edhe për aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese që kanë pasur më së shumti ndikim në sundimin e së drejtës dhe mbrojtjen e kushtetutshmërisë në vend, duke theksuar njëherësh obligimin kushtetues për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Për bashkëpunimin e Gjykatës Kushtetuese me Komisionin e Venecias, parashtrimin e kërkesave nga dhe në Forumin e Komisionit të Venecias, si dhe numrin e përgjithshëm të kërkesave të parashtruara deri më tani, studentët u informuan më në detaje nga drejtori i ZKI dhe njëherësh Zyrtari ndërlidhës i Gjykatës Kushtetuese me Komisionin e Venecias, z. Veton Dula.

18 prill 2019

Gjykatën Kushtetuese e vizitoi një grup studentësh të Fakultetit Juridik të Kolegjit “AAB” në Prishtinë, më 18 prill 2019.

Studentët u pritën në takim nga këshilltari juridik senior i Gjykatës Kushtetuese, z. Bardh Bokshi dhe nga drejtori i Zyrës për Komunikim dhe Informim (ZKI), z. Veton Dula.

Këshilltari Bokshi fillimisht i njoftoi studentët më për së afërmi me strukturën organizative dhe me përbërjen e Gjykatës, me procedurat për përzgjedhjen dhe për emërimin e gjyqtarëve kushtetues, me procesin e vendimmarrjes së Gjykatës, si dhe me kompetencat dhe përgjegjësitë që gëzon Gjykata Kushtetuese në bazë të Kushtetutës.

Në vazhdim të takimit, këshilltari Bokshi veçoi disa prej aktgjyimeve më me rëndësi të Gjykatës në fushën e shkeljes së të drejtave të njeriut nga autoritetet publike, konfliktit të kompetencave kushtetuese ndërmjet organeve të ndryshme të pushtetit shtetëror si dhe ruajtjes së pavarësisë funksionale të institucioneve të pavarura.

Ai diskutoi edhe për rëndësinë dhe obligimin kushtetues për zbatimin e jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese si dhe të gjykatave të niveleve të tjera të gjyqësorit të rregullt në Republikën e Kosovës. Studentët nga ana e tyre shprehën interesimin që të informohen më në detaje përkitazi me zbatimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, procesin e parashtrimit të kërkesave në Gjykatë,

natyrën e kërkesave të parashtruara, kohëzgjatjen e shqyrtimit të lëndëve, si dhe për trajtimin e pyetjeve të mediave dhe publikut rreth lëndëve në shqyrtim.

15 - 17 maj 2019

Një delegacion i gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kroacisë, në krye me kryetarin e kësaj gjykate, z. Miroslav Šeparović, qëndroi për vizitë pune në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Delegacioni kroat u prit në takim nga Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, znj. Arta Rama-Hajrizi dhe Zëvendëskryetari i Gjykatës, z. Bajram Ljatifi. Kryetarja Rama-Hajrizi i informoi mysafirët me punën e deritanishme të Gjykatës Kushtetuese, me procesin e ripërtëritjes së përbërjes së gjyqtarëve kushtetues vitin e kaluar si dhe me sfidat e tejkaluara me sukses pas zëvendësimit të ish-gjyqtarëve ndërkombëtarë me gjyqtarë vendor.

Kryetarja Rama-Hajrizi në vazhdim e falënderoi homologun e saj kroat, z. Šeparović, për përkrahjen që Gjykata Kushtetuese e Kroacisë i ka ofruar në vazhdimësi Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në përpjekjet për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare si dhe në ngritjen e kapaciteteve profesionale të zyrtarëve të saj nëpërmjet projekteve të përbashkëta për shkëmbim përvojash.

Ajo u zotua për intensifikimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit ndërmjet dy gjykatave homologe, duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit të ndërsjellë veçanërisht në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe harmonizimit të praktikës gjyqësore me atë të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Pasi që e falënderoi Kryetaren Rama-Hajrizi për mikpritjen, Kryetari Šeparović bëri një përshkrim të përgjithshëm të funksionimit të gjyqësorit kushtetues në Republikën e Kroacisë dhe konfirmoi vullnetin e palëkundur për vazhdimin e bashkëpunimit ndërmjet dy gjykatave në të gjitha fushat me interes reciprok.

Pas takimit, gjyqtarët e të dy gjykatave kushtetuese mbajtën një punëtori të përbashkët në temat: *“Kompetenca e gjykatës kushtetuese përkitazi me shqyrtimin e marrëveshjeve ndërkombëtare”, “Marrëveshjet kolektive para Gjykatës Kushtetuese” dhe “Mosmarrëveshjet zgjedhore nga perspektiva e gjykimit kushtetues”.*

21 maj 2019

Studentë të vitit të parë të Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, vizituan Gjykatën Kushtetuese, më 21 maj 2019, të cilët në takim i pritën gjyqtari i Gjykatës, z. Bekim Sejdiu dhe këshilltari juridik senior, z. Bardh Bokshi.

Gjatë bashkëbisedimit me studentë, gjyqtari Sejdiu diskutimin e tij e përqendroi kryesisht në rolin që luan Gjykata Kushtetuese në mbrojtjen e kushtetutshmërisë në vend dhe në garantimin e funksionimit të organeve shtetërore në harmoni me përgjegjësitë dhe me obligimet e tyre kushtetuese.

Procedurat e zbatuara në shqyrtimin e parashtrësive kushtetuese, procesi dhe fazat e shqyrtimit të tyre, përzgjedhja e kolegjeve shqyrtuese të gjyqtarëve dhe mënyra e vendimmarrjes ishin po ashtu temë e prezantimit të gjyqtarit Sejdiu.

Këshilltari Bokshi ndërkaq studentët i njoftoi më hollësisht me disa prej vendimeve më me rëndësi të Gjykatës dhe ndikimin që ato patën në vendosjen e praktikës gjyqësore kushtetuese në vend.

Raporti me gjykatat e rregullta, zbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nga institucionet e tjera si dhe kriteret për pranueshmërinë e kërkesave të palëve parashtruese, ishin çështjet për të cilat juristët e ardhshëm shprehën interesimin e tyre në vijim të takimit.

27 maj 2019

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Arta Rama-Hajrizi, priti në takim ish-gjyqtaren e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) nga Maqedonia e Veriut dhe ish-gjyqtaren e Gjykatës Kushtetuese të këtij vendi, znj. Mirjana Lazarova-Trajkovska.

E angazhuar në cilësinë e ekspertes në kuadër të projektit të mbështetur nga Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë dhe nga ambasada e Norvegjisë në Kosovë, znj. Lazarova – Trajkovska qëndroi për vizitë pune njëjavore në Gjykatën Kushtetuese, me qëllim të shkëmbimit të përvojës personale si ish-gjyqtare e GJEDNJ-së dhe për zbatimin e praktikave më të mira të punës nga ky institucion, së bashku me gjyqtarët dhe me këshilltarët e rinj të Gjykatës.

Gjatë bashkëbisedimit me znj. Lazarova–Trajkovska, Kryetarja Rama-Hajrizi vuri theksin në konsolidimin e praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese duke pasur gjithmonë si udhërrëfyes praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në raportet e shkëlqyera të bashkëpunimit me gjykatat kushtetuese të vendeve të rajonit dhe me ato evropiane si dhe në përpjekjet e vazhdueshme që po bëhen për avancimin e cilësisë së procesit vendimmarrës të Gjykatës.

Kryetarja Rama-Hajrizi falënderoi në veçanti Zyrën e Këshillit të Evropës për mbështetjen e ofruar Gjykatës Kushtetuese ndër vite nëpërmjet projekteve të ndryshme për ngritje të kapaciteteve profesionale, përfshirë këtu edhe projektin e fundit që filloi së zbatuari në mars të këtij viti, nëpërmjet të cilit synohet zbatimi më efektiv i standardeve evropiane në trajtimin e ankesave kushtetuese individuale dhe komunikimi më efikas me publikun.

27 maj 2019

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës në bashkëpunim me Akademinë e Drejtësisë të Republikës së Kosovës organizuan punëtorinë e përbashkët në temën: *“Roli dhe kompetencat e Gjykatës Kushtetuese. Raporti me gjykatat e rregullta dhe institucionet e tjera”*, e cila u mbajt në gjykatoren e Gjykatës Kushtetuese.

Punëtorja e mbajtur pati për qëllim informimin e gjyqtarëve të rinj të Kosovës, me autoritetin dhe me rolin që ka Gjykata Kushtetuese në raport me gjyqësorin e rregullt, si dhe me institucionet e tjera në vend, për të cilat ata u njoftuan më për së afërmi nga këshilltari i parë juridik i Gjykatës, z. Sevdail Kastrati.

Procedurat e parashtrimit dhe të shqyrtimit të lëndëve, trajtimi i ankesave individuale ndaj vendimeve të gjykatave të rregullta, si dhe e drejta e referimit të rasteve në shqyrtim nga gjykatat e rregullta në Gjykatën Kushtetuese nëpërmjet kontrollit incidental (konkret), ishin vetëm disa prej temave rreth të cilave këshilltari Kastrati në vazhdim përqendroi prezantimin e tij.

Shqyrtimi i kërkesave që kanë të bëjnë me tejzgjatjen e procedurave gjyqësore nga gjyqësori i rregullt, afatet kohore për shqyrtimin e lëndëve në Gjykatën Kushtetuese dhe trajtimi i lëndëve me prioritet, sidomos në rastin e kërkesave të parashtruara nga autoritetet publike, ishin disa nga çështjet për të cilat gjyqtarët e rinj shprehën interesimin e tyre që të informohen më hollësisht.

Përkitazi me marrëdhënien e bashkëpunimit ndërmjet Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe Komisionit të Venecias, mysafirët i njoftoi më në detaje Drejtori i Zyrës për Komunikim dhe Informim, z. Veton Dula, njëherësh Zyrtar ndërlidhës i Gjykatës Kushtetuese me Komisionin e Venecias.

29 maj – 1 qershor 2019

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës mbajti punëtorinë e Planit të Veprimit të Planit Strategjik të Gjykatës Kushtetuese 2018 - 2020, më 29 maj - 1 qershor 2019, në Durrës, Shqipëri.

6 qershor 2019

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Arta Rama-Hajrizi, priti në takim Avokatin e Popullit të Republikës së Shqipërisë, znj. Erinda Ballanca, të shoqëruar nga homologu i saj në Kosovë, z. Hilmi Jashari.

Pasi që i shprehu mirëseardhjen, Kryetarja Rama-Hajrizi e njoftoi znj. Ballanca me të arriturat e fundit që ka shënuar Kosova në fushën e gjyqësisë kushtetuese, si dhe me sfidat e përballura në punën e Gjykatës Kushtetuese gjatë vitit të kaluar, pas largimit të njëkohshëm të katër gjyqtarëve, dy prej tyre ndërkombëtarë.

Ajo vuri theksin në raportet e shkëlqyera me institucionet homologe në rajon, e veçanërisht me Gjykatën Kushtetuese të Shqipërisë, si dhe në përpjekjet e vazhdueshme që po bëhen për konsolidimin e kapaciteteve profesionale të Gjykatës, duke u bazuar në standardet e përfaqësuara nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Në takim u theksua edhe nevoja e bashkëpunimit ndërinstitucional ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë për plotësimet e nevojshme të kuadrit ligjor, me qëllim të thellimit të reformave të mëtutjeshme në sistemin gjyqësor të të dyjave vendeve dhe për përvetësimin e praktikave evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Të dyja palët gjithashtu nënvizuan rëndësinë e respektimit të ndarjes së pushteteve dhe ruajtjen e pavarësisë funksionale të gjykatave dhe të institucioneve të pavarura, si parakusht thelbësor për funksionimin e demokracisë kushtetuese në çdo vend.

7 qershor 2019

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës në bashkëpunim me Zyrën e Këshillit të Evropës në Prishtinë organizuan punëtorinë e përbashkët në temën: *“Standardet evropiane për të drejtat e njeriut mbi kohëzgjatjen e arsyeshme të procedurave”*, në Prishtinë.

Koncepti i kohëzgjatjes së arsyeshme në procedimin e kërkesave, vështruar nga perspektiva e praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, arsyet më të shpeshta për vonesat në procedurë gjyqësore, mekanizmat parandalues dhe kompensues në rastet e procedurave të tejzgjatura si dhe standardet evropiane për të drejtat e njeriut mbi kohëzgjatjen e arsyeshme të procedurave, ishin vetëm disa prej temave që u diskutuan në punëtori.

Panelistë dhe folës kryesor në punëtorinë e organizuar ishin: z. Bajram Ljatifi, Zëvendëskryetar i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, z. Miodrag Đorđević, Zëvendëskryetar i Gjykatës Supreme të Sllovenisë, znj. Maria Filatova, ish-avokate në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe znj. Mirela Bogdani, ligjëruese në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës.

Punëtorja e mbajtur shënon aktivitetin e radhës në kuadër të projektit të mbështetur nga Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë dhe nga ambasada e Norvegjisë në Kosovë, që synon avancimin e kapaciteteve profesionale të Gjykatës Kushtetuese, me qëllim të zbatimit më efektiv të standardeve evropiane në trajtimin e ankesave individuale dhe komunikimin me publikun.

9 korrik 2019

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës në bashkëpunim me Zyrën e Këshillit të Evropës në Prishtinë organizuan punëtorinë e përbashkët në temën: *“Standardet Evropiane të të Drejtave të Njeriut mbi Kriteret e Pranueshmërisë”*, e cila u mbajt në Prishtinë, më 9 korrik 2019.

E drejta e individëve për të parashtruar kërkesë në Gjykatat Kushtetuese, papranueshmëria e kërkesave në lidhje me juridiksionin e Gjykatës dhe kriteret e pranueshmërisë së kërkesave të zbatuara nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ishin vetëm disa prej temave që u diskutuan në këtë punëtori.

10 korrik 2019

Një grup studentësh të Universitetit Amerikan në Kosovë (AUK) vizituan Gjykatën, më 10 korrik 2019. Studentët u pritën në takim nga gjyqtarja Gresa Caka-Nimani.

16 - 19 shtator 2019

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës mbajti punëtorinë mbi Planin e Veprimit të Gjykatës Kushtetuese, më 16 - 19 shtator 2019, në Durrës, Shqipëri.

shtator 2019

Në kuadër të projektit të Këshillit të Evropës në Prishtinë *“Përmirësimi i Mbrojtjes së Standardeve Evropiane për të Drejtat e Njeriut nga Gjykata Kushtetuese”*, që synon avancimin e kapaciteteve profesionale të Gjykatës Kushtetuese, filloi me vendosjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në Gjykatën për të Drejtat e Njeriut në Strasburg.

Përgjatë muajit shtator 2019, Gjyqtari Bekim Sejdiu, u vendos në GJEDNJ për një vizitë studimore njëmuje.

tetor 2019/ nëntor 2019

Në kuadër të projektit të Këshillit të Evropës në Prishtinë *“Përmirësimi i Mbrojtjes së Standardeve Evropiane për të Drejtat e Njeriut nga Gjykata Kushtetuese”*, që synon avancimin e kapaciteteve profesionale të Gjykatës Kushtetuese, filloi me vendosjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në Gjykatën për të Drejtat e Njeriut në Strasburg.

Përgjatë muajit tetor 2019, Zëvendëskryetari Bajram Ljatifi dhe Gjyqtari Safet Hoxha u vendosën në GJEDNJ për një vizitë studimore njëmuje. Ndërsa, përgjatë muajit nëntor 2019, Gjyqtarja Remzie-Istrefi u vendos në GJEDNJ për një vizitë studimore njëmuje.

Organizimi i Vitit të Dhjetë Gjyqësor

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës kremtoi jubileun e Vitit të 10-të Gjyqësor me një ceremoni solemne që u mbajt në Prishtinë, më 23 tetor 2019.

Hapja e ceremonisë jubilarë u bë me një fjalim rasti nga Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, znj. Arta Rama-Hajrizi, në të cilën pjesëmarrës ishin personalitetet më të larta shtetërore e ndërkombëtare në vend, si dhe delegacionet e nivelit më të lartë nga gjykatat kushtetuese të vendeve të rajonit dhe të vendeve të tjera evropiane.

Me fjalim rasti, pjesëmarrësve në ceremoninë solemne iu drejtuan edhe juristja ndërkombëtare dhe njëherësh përfaqësuesja e Republikës së Irlandës në Komisionin e Venecias, znj. Grainne McMorro si dhe ish-gjyqtarja ndërkombëtare e Gjykatës Kushtetuese, Prof. dr. Snezhana Botusharova.

Me rastin e shënimit të Vitit të 10-të Gjyqësor të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, u mbajt Konferenca ndërkombëtare në temën: *“Sigurimi i sundimit të ligjit dhe i të drejtave të njeriut përmes mekanizmave të drejtësisë kushtetuese: Sfidat e shekullit 21”*, më 24 tetor 2019.

Konferencën e shpalli të hapur Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, znj. Arta Rama-Hajrizi. Në vazhdim të konferencës me prezantimet e tyre u paraqitën: z. Jean - Claude Wiwinius, Kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Luksemburgut, Prof. dr. Bekim Sejdiu, Gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, z. Enver Peci, Kryetar i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, z. Hilmi Jashari, Avokat i Popullit si dhe gjyqtarët e gjykatave kushtetuese të Malit të Zi, të Republikës Çeke, të Maqedonisë së Veriut, të Portugalisë dhe të Turqisë.

21 - 22 nëntor 2019

Në kuadër të projektit të Këshillit të Evropës në Prishtinë *“Përmirësimi i Mbrojtjes së Standardeve Evropiane për të Drejtat e Njeriut nga Gjykata Kushtetuese”*, u organizua tryeza e rrumbullakët në temën: *“Parimet dhe Metodologjia e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*, e cila u mbajt më 21 dhe 22 nëntor 2019, në Prishtinë.

Procedimi i rasteve në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), metodat administrative të GJEDNJ-së, subsidiariteti dhe aplikimi i metodave të GJEDNJ-së nga gjykatat kombëtare, ishin vetëm disa prej temave që u diskutuan në këtë tryezë me gjyqtarë dhe këshilltarë të Gjykatës Kushtetuese.

Panelistë dhe moderatorë të tryezës ishin: Dr. Kanstantsin Dzehtsiarou, ligjërues i së drejtës në katedrën e Fakultetit Juridik të Universitetit të Liverpulit në Angli dhe z. Velimir Delovski, ekspert i të drejtave të njeriut nga Republika e Maqedonisë.

5 dhjetor 2019

Në kuadër të projektit të Këshillit të Evropës në Prishtinë *“Përmirësimi i Mbrojtjes së Standardeve Evropiane për të Drejtat e Njeriut nga Gjykata Kushtetuese”*, u organizua Konferenca Ndërkombëtare mbi temën: *“Liria e shprehjes dhe jurisprudenca kushtetuese në Ballkanin Perëndimor”*, që u mbajt më 5 dhjetor 2019, në Prishtinë.

Në këtë Konferencë morën pjesë gjyqtarët dhe këshilltarët kushtetues-juridikë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, znj. Arta Rama-Hajrizi mbajti fjalë hyrëse ndërsa në mesin e folësve kryesor në konferencë, që për qëllim pati edhe diskutimin dhe shkëmbimin e përvojave të gjykatave kushtetuese të rajonit në zbatimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ishte edhe gjyqtarja e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, znj. Remzije Istrefi-Peci, e cila mbajti një prezantim në çështjen e lirisë së shprehjes për gjyqtarët sipas praktikës së GJEDNJ-së.

Në vijim folësit kryesorë në konferencë ishin: z. Naser Ajdari, gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të Maqedonisë së Veriut, znj. Mirjana Lazarova, ish-gjyqtare në GJEDNJ, znj. Beth Grossman, avokate në Britaninë e Madhe, z. Paolo Cavalieri, profesor i së drejtës së mediave në Universitetin e Edinburgut, znj. Fatma Gülbin Üzcüre, këshilltare e lartë ligjore në Gjykatën Kushtetuese të Turqisë dhe znj. Sevima Sali Terzić, këshilltare e lartë ligjore në Gjykatën Kushtetuese të Bosnjë e Hercegovinës.

Në vijim të konferencës u shfaq edhe video-animacioni i realizuar nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës, me përkrahjen e Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë, përkritazi me të drejtën dhe mënyrat e parashtrimit të kërkesave nga individët dhe palët e tjera të autorizuar në Gjykatën Kushtetuese.

SHTOJCA I

SHTOJCA I

Përmbledhje e llogarive të Gjykatës Kushtetuese për vitin 2019

Shën.	2019			2018			2017		
	Llogaria e vetme e Thesarit		Pagesat nga palët e treta të jashtme	Llogaria e vetme e Thesarit		Pagesat nga palët e treta të jashtme	Llogaria e vetme e Thesarit		Pagesat nga palët e treta të jashtme
	BKK	T H V		BKK	T H V		BKK	T H V	
	€	€	€	€	€	€	€	€	€
Pranimet									
Ndarjet nga Fondi i përgjithshëm	1,957,335.82			1,697,491.00			569.42		
Të hyrat vetanake									
Ndarjet nga Fondi me qëllime të dedikuara									
Grantet e përcaktuara të donatorëve							22,426.08		
Fondi i huazimeve									
Pranimet e tjera									
Totali i pranimeve	1,957,335.82	-		1,697,491.00	-	-	1,527,572.42	-	-
Pagesat									
Operacionet									
Pagat dhe mëditjet	2	1,288,021.58		1,137,566.66			998,705.93		
Mallrat dhe shërbimet	3	420,473.40		512,153.66			500,301.08		
Shërbimet komunale	4	2,652.28		3,246.63			3,562.41		
		<u>1,711,147.26</u>		<u>1,653,296.95</u>			<u>1,502,569.42</u>		
Transferet									
Transferet dhe subvencionet	5								
Shpenzimet kapitale									
Prona, ndërtesa dhe pajisjet	6								
Kthimi i huamarrjes	7	246,188.56		44,194.79			25,000.00		
Pagesat e tjera	8								
Pagesat gjithsej	1,957,335.82	-		1,697,491.74	-	-	1,527,569.42	-	-

Pasqyra e pranimit dhe pagesave në para të gatshme

Raporti mbi ekzekutimin e buxhetit

	Shënime	2019				2018	2017
		Buxheti fillestar (Ndarja)	Buxheti final (Ndarja)	Realizimi	Dallimi	Realizimi	Realizimi
		A	B	C	D=C-B	E	F
		€	€	€	€	€	€
Hyrja e parasë së gatshme në llogari të Thesarit							
Të hyrat tatimore	9						
Të hyrat jo tatimore	10						
Të hyrat e dedikuara	11						
Grantet dhe ndihma	12						
Huamarrje	13						22,426
Tjera	14						
Pranimet totale të mbledhura për BKK		-	-	-	-	-	-
Dalja e parasë së gatshme nga llogaria e Thesarit							
Pagat dhe mëditjet	2	1,187,745.00	1,288,021.58	1,288,021.58	0	1,137,867	998,706
Mallrat dhe shërbimet	3	491,702.00	420,486.00	420,473.40	(47)	512,184	500,301
Shërbimet komunale	4	4,000.00	3,000.00	2,652.28	(348)	3,247	3,562
Transferet dhe subvencionet	5						
Shpenzimet kapitale	6	185,000.00	246,216.00	246,188.56	(27)	44,195	25,000
Fondi i privatizimit	7						
Të tjera	8						
Totali i pagesave të bërë nga BKK		1,868,447.00	1,957,723.58	1,957,335.82	(422)	1,697,491	1,527,569

Ndarjet e fondit të përgjithshëm për vitin 2019

Klasifikimi ekonomik	2019			2018	2017
	BKK	THV	Totali		
	€	€	€	€	€
Pagat dhe mëditjet	1,288,021.58		1,288,021.58	1,137,867	998,706
Mallrat dhe shërbimet	420,473.40		420,473.40	512,184	500,301
Shërbimet komunale	2,652.28		2,652.28	3,246	3,562
Subvencionet dhe transferet					
Shpenzimet kapitale	246,188.56		246,188.56	44,195	25,000
	1,957,335.82	-	1,957,335.82	1,697,491	1,527,569

ORGANOGRAMI



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

